



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Mr. No. Pp:

04/12/2023
02/561



REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 23.11.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VII- (shtatë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës.

REND I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Statutit të Komunës së Malishevës.
- 2.Shqyrtimi i Raportit të DKAË për fillimin e vitit shkollor 2023/2024.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandieve, sipas rekomandimit të zyrës Kombëtare të Republikës së Kosovës për të gjeturat e vitit 2022.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/287, e parashtruar nga Shkelzen Kryeziu.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/57, e parashtruar nga Liridon Gashi.
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/403, e parashtruar nga Sami Thaçi.
- 9.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 30.08.2023 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin:24 asambleistë, nënkryetari Vesel Krasniqi, drejtorë komunal: Blerim Thaçi, Sylë Dukolli, Bashkim Krasniqi,përfaqësues nga OSBE-ja, përfaqësues nga KDI dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhë në mbledhjen e shtatë të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Të pranishëm jemi 24 anëtarë të kuvendit, përfaqësuesit nga OSBE-ja, dhe përfaqësuesit e KDI-së. Kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë me punimet e seancës. Para se të fillojmë me rendin e ditës i kemi në dispozicion 30 min për debat jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Unë dua ta ngris një shqetësim të qytetarëve që ka të bëjë me energjin elektrike në Komunën e Malishevës. Komuna e Malishevës është duke u përballur me një gjendje të tmerrshme të enegjis elektrike, të gjithë e dini që me datën 27 të këtij muaji energjia elektrike është ndërpre për 12 orë. Me informimin e KEDS-it energjia elektrike ka pasur të lëshohet në ora: 15:00, por pa asnjë arsye, pa asnjë përgjegjësi energjia elektrike ka vazhduar ndërprerjet deri në ora 22:00. Kjo për Komunën e Malishevës është një situat shumë e vështirë, sikur KEDS-it nuk i mjafton kjo ndërprerje ditën e diel, sot KEDS-i ka vendosur ta vazhdoj për territorin e fshatit Dragobil, Pagarushë, Maxharrë, Shkozë, Janqistë të cilat janë pa rrymë nga ora 08:00 në mëngjes. Nuk e di qfarë përgjegjësie duhet të jetë kjo situatë nga ana e kompanis KEDS-I dega në Malishevë. Unë kërkoj nga institucionet komunale pozit dhe opozit, në mënyr demonstrative të shkojmë para KEDS-it të bëjmë protest, dhe të kërkojmë llogari për gjendjen që është duke ja bërë qytetarëve të Komunës së Malishevës. Dhe viteve të tjera në sezonin dimëror e dimë në qfarë gjendje ka qenë energjia elektrike në Komunën e Malishevës, të vazhdoj dhe kjo sezonë tani kur më së shumti kemi nevojë si bizneset dhe po ashtu qytetarët. Të bëjë hajgare KEDS-i me qytetarët e Komunës së Malishevës, për mua si përfaqësues i atyre që më kanë besuar dhe i gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës është e pa pranueshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani: Përshëndetje për të gjithë!

Ditë më parë Kosova u trondit nga vdekja e një gruaje 38 vjeqare, nënë e 4 fëmijëve në fshatin Ngucat. Ajo gjatë trajtimit në një klinik stomatologjike në Malishevë, gjatë marrjes së një ineksioni anestezion i përkeqësohet gjendja dhe e gjenë vdekjen. Unë nuk dua të hyjë në detaje të këtij rasti, sepse nuk kam ndonjë raport zyrtar të rastit, por gjatë kësaj foltore dua t'i shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjen Shala nga fshati Ngucat dhe familjen Kryeziu nga fshati Pagarushë, duke bashkë ndje me të dy familjet e së ndjerës.

Drejtori i Inspektoriatit nuk është prezent por kërkoj nga Drejtoria e Inspektoriatit që t'i shfrytëzoj të gjitha mundësit e nevojshme të lejuara në bazë të ligjit dhe të kontrollojë të gjitha ordinancat private, laboratorët, barnatoret dhe të raportoj në Kuvend për gjendjen e tyre.

Në munges të Drejtorit të Shëndetësis pyetja ime është: a është funksional reparti i stomatologjisë në Malishevë? Cilat janë shërbimet të cilat i ofronë dhe cili është orari i punës, a ka stomatologë të mjaftueshëm në QKMF në Malishevë?

Lidhur me këtë rast kam vërejtje për grupin e grave asambleiste dhe gratë të cilat udhëheqin organizata për gra, të cilat nuk e kanë bërë asnjë reagim në këtë rast, asnjë telegram ngushëllimi, asnjë organizim për marsh paqësor për vdekjen e një nëne, të një gruaje gjatë trajtimit shëndetësor të saj.

Të nderuar unë uroj që ky rast me qenë i fundit duke kërkuar nga institucionet lokale dhe qëndrore që ta përfundojnë punën e tyre dhe të dimë se ku po trajtohem.

Po e shoh që dy javë është jo funksional ueb faqja komunale, sidomos tani kur është procesimi i të dhënave për transparencë komunale dhe për performancë komunale, e cila do të pamundëson dhe përfitimin e granteve nga niveli qendror. Si kuvend i Komunës duhet të bëjmë një reagim publik lidhur me këtë mos funksionim të ueb faqes Komunale të Komunës tonë.

Po ashtu i bashkangjitem shqetësimit të kolegut tim Arlind Morina, për problemet me energji elektrike në Komuën e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Pa dashur me i përsërit të njëjtat tema që i cekën Arlindi dhe Amrush, dhe ne si grup i asambleistëve i shprehim ngushëllime familjes dhe të gjithëve për vdekjen e Leonorës dhe kërkoj nga Inspektoriati dhe Drejtoris së Shëndetësisë dhe çdo herë kam kërkuar që Drejtori i Shëndetësisë të jetë prezent, sepse kemi pasur pyetje të tilla për të. Ky rast duhet me u trajtu në mënyrën më të drejtë të mundshme dhe me i dhënë epilog të drejt, sepse është fatkeqësi e madhe që në mes të qendrës së qytetit operon një ordinancë që po thuhet që ka qenë ilegale dhe nuk i ka plotësuar kushtet, dhe nëse ka ndodhur kjo është tmerr që mundet me na ndodh neve si shoqëri. E kam dhe një shqetësim shtesë mungesën e ujit, si komunë nuk po i plotësojmë kriteret, burimet e ujit dhe kam dyshime që dhe atë pak ujë që kemi po keqpërdoret. Po kërkoj dhe një herë qoftë nga kompania apo nga inspektoriati me dalë me i inspektu këto zona, sepse është e padrejtë dikush me e ujit tokën bujqësore me ujë të ujësjellësit, e dikush tjetër mos me pas ujë as për pije epastrim.

Avdia nuk qenka këtu, e di e ka përmendur shumë herë mos mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe unë prapë po e ritheksoj se çka është duke ndodhur me mirëmbajtjen e këtyre rrugëve. Vetëm në fshatin Lladroc janë 12 prerje. Komuna duhet me nxjerr vendim, që banori që e bënë prerjen e rrugës të bëjë dhe riparimin e rrugës me mjetet e tij financiare ose me shku komuna me mjetet tona me bërë riparimin e rrugës.

Ne e kemi parë investimin në rrugën “Ibrahim Mazreku” tek bulevardi që është shfrytëzuar maksimalisht nga qytetarët, mirëpo i kam parë që disa biznese kanë filluar prapë me i vendos disa shkallë në trotuar, a është kjo e toleruar nga ana juaj apo janë vendosur në vendin e duhur. Faleminderi!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam një pyetje për ekzekutivin më konkretisht për Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër, Inspektoriatin dhe Urbanizmin. Unë kam pritur një reflektim të punës së tyre në teren për qështjen e disa mbeturinave të cilat janë të vendosura në fshatin Turjakë në rrugën “Imer Mullamuqa”. Meqenëse në teren është duke u punuar rreth implementimit të projektit për asfaltimin e kësaj rruge shqetësimi është që pengesat të cilat kanë qenë të vendosura me vite të tëra aty, dhe pas kërkesave të shumta nga komuniteti për ndërmarrje të masave për eliminimin e atyre mbetjeve të veturave të prishura dhe pas marrjes së vendimit nga zyra kryesore ajo pjesë është e ozurpuar. Zhavori i cili është duke u shtruar është duke u bërë në mënyrë jo adekuate, për mendimin tim, do të ishte më mirë të na jep përgjigjie më të sakt sektori përkatës, më saktësisht Drejtori i Gjeodezis se qfarë masa ka ndërmarr departamenti i qështjes pronësore juridike për eliminimin e këtyre pengesave. Po ashtu a është konsultuar Gjeodezia me i caktu pikat se nga duhet të vendosen, qfarë bashkëpunimi ka pasur me inspektoriatin?

Urbanizmi, kur e ka kontraktuar kompanin për zbatimin e kësaj rruge, a është konsultuar me këto

sektor?

Tjetër gjë që më ka nxit me parashtru këtë problem është dhe kërkesa e fondacionit të bashkë atdhetarëve e cila është themeluar me iniciativën e bashkëatdhetarëve tanë, kam qenë prezent dhe në një takim gjatë muajit gusht ku ata kanë ndihmu me mjete financiare fshatin, kryesisht veprimtari e tyre është qështja humanitare dhe qështja e mbajtjes së ambientit. Shqetësim i tyre është largimi i pengesave në hapsirat publike, po ashtu ozurpimi që kanë qenë në hapsirat publike të kjo rrugë. Pra dhe iniciativa që ata kanë marrë si bashkëatdhetarë për me kontribu në aspektin e mirëmbajtjes së ambientit me gjelbrim dhe kjo është pamundësuar për arsye të mos veprimit të institucioneve përkatëse.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Shqetësimin që dëshirova me ngrit e cekën dhe parafolësit, rasti i të ndjerës një rast kaq i rëndë dhe fatkeqësisht nuk e ka marrë vëmendjen e duhur institucionale as të këtyre lokal dhe atyre qëndror. Është një rast i rëndë dhe një problematik shumë e madhe sepse ndërhyrja dentare siç është heqja e dhëmbit llogaritet si një ndërhyrje jo e rëndë, dhe për një ndërhyrje të tillë me marrë jetë njeriu është shumë problematike. Përse duhet të vlejë kaq pak jeta e njeriut të ne?

Unë kurrë nuk e kam parë atë Ordinancë, por me pamjet të cilat i kam parë në media të asaj ordinance, mjafton pamja e jashtme me kuptu qfarë gjendje të mjerueshme ka qenë. Si lejohet me operu si ordinancë, një objekt i tillë, me njerëz jo profesional, ku është Inspektoriati sanitar, Inspektoriati i punës, Inspektoriati shëndetësor?

Unë e di që janë të gjitha nga niveli qëndror, por kemi përgjegjësi dhe ne si nivel lokal, nëse ne vërejmë ndonjë nga ordinancat apo cilindo biznes që nuk është duke punuar në mënyrën e duhur, nuk është kompetenca jonë por ne duhet me i informuar organet kompetente. Në qoftëse shohim që nuk ka kushte të mira higjienike një biznes i caktuar është obligim i inspektoriatit me informu inspektoriatin sanitar. Nuk duhet ne vetëm pasi ka ndodhur me u marrë me pasoja, duhet një sensibilizim më i madh, pasi që njëherë na ndodhi një pasojë me vdekje. Kërkoj nga Inspektoriati i Komunës së Malishevës që të i bëjë ftesë inspektoriatit sanitar që të i inspektoj të gjitha ordinancat private që operojnë në Komunën e Malishevës, se a janë të kualifikimit të duhur.

E cekë Arlindi problemin e rrymës ne e dimë që kanë intervenime dhe kanë punë por është e pa logjikshme me të lënë 12 orë pa rrymë, mundesh me ndal 4 maksimumi deri në 5 orë, mirëpo 12 orë me blloku një rajon të caktuar kjo është e pa imagjinueshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Shqetësimi im kryesor është pa pastërtia në Bulevardin "Ibrahim Mazreku", ku shohim se për një kohë shumë të shkurtër bulevardi ka marrë një pamje tjetër nga ajo që ka qenë në fillim ku pa pastërtia është rritur shumë. Kërkoj nga drejtoria e shërbimeve publike ta mbikqyr kompaninë e pastrimit, gjithashtu i ftoj të gjithë qytetarët që të gjithë së bashku ta mirëmbajmë bulevardin. Të gjithë jemi përgjegjës për mirëmbajtje ashtu siç i mirëmbajmë shtëpitë tona ashtu duhet ta mirëmbajmë dhe pronën publike. Kërkoj nga kompania që ta bëjë pastrimin me ujë trotuarin që Malisheva urbane të jetë ashtu si e meriton dhe jo vetëm të largohen mbeturinat.

Gjithashtu shfrytëzoj rastin të shprehi ngushëllime dhe familjes nga Ngucati për humbjen e nuses së tyre, gjithashtu dhe familjes Kryeziu nga Pagarusha për bijën e tyre.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Po ndërlihdna dhe unë te shqetësimet të cilat i shprehën kolegët e mi, te rasti i të ndjerës Leonora ky rast na ka prek të gjithëve qytetarëve të Komunës së Malishevës, por dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ka qenë një rast shumë i ndjeshëm por fatkeqësia më e madhe ka qenë që kanë mbetur 4 fëmijë jetim dhe ata fëmijë do të rriten pa nënë. Unë e kam parë që askush nuk ka marrë përgjegjësi dhe më ka ardhur shumë keq, nuk kam parë nga ana e ekzekutivit ndonjë reagim pra nga ana e Kryetarit të Komunës z.Kastrati, që është dashur me dhënë sqarime se përse ka ndodhur dhe përse nuk ka pasur regjistrim të ati biznesi apo si ka operuar. Ordinaca në fjalë është pak metra afër qendrës së mjeksisë familjare kjo është për të ardhur keq dhe gjitha këto kanë ndodhur për arsye të pakujdesis dhe për arsye të neglizhencës që ne si organe institucionale po i injorojmë. Unë e di që është duke u marrë hetuesia dhe prokuroria por të paktën është dashur me u solidarizu ne si institucione me nda dhimbjen. E ka postu ueb faqja e komunës që ka shkuar Kryetari i ka shprehur ngushëllime dhe me atë ka përfunduar, nuk duhet me përfundu me kaq. Duhet njerëzit përgjegjës me dal para drejtësis dhe me dhënë sqarime se përse ka ndodhur. Drejtoria e Inspektoriatit është dashur me dhënë një sqarim se përse ka ndodhë, dhe përse ka ardhur deri te humbja e jetës së zonjës në fjalë.

Shqetësimi tjetër është energjia elektrike që e ceki Arlindi, prap nuk ka pasur një reagim, vetëm një reagim të vogël e kam parë të Drejtorit të Urbanizmit në rrjetin e tij social që është dukur shumë privat.

Te mungesa e prezencës së Drejtorit të Shëndetësis që faktikisht na injoron, qe dy vite funksionon Kuvendi dhe nuk vjen, kam kërkuar disa herë shpjegime për qështje të ndryshme por nuk kemi marrë asnjëherë përgjigjie. Dikush pyeti a kemi dentist në ambullant, kemi por deri në ora 12:00 ose në ora 13:00 mbas dite ata dalin dhe i kanë ordinancat private sikur qysh ndodhi rasti. E kemi dhe repartin e gjinekologjisë është i njëjti rast, sepse dhe këta vetëm paradite punojnë dhe pastaj vazhdojnë në ordinancat e tyre. Qytetarët pasi që nuk i marrin shërbimet aty, janë të obliguar pastaj të shkojnë te çdo kush me gjet dhe vdekjen.

Ja sa të përgjegjshëm jemi ne, po kërkoj dhe njëherë prej Drejtoris së Shëndetësis me qenë më korrekte, dhe kërkoj nga Kryetari të ndërmerr masa, të vjen Drejtori i Shëndetësis këtu, ose të vjen drejtori i qendrës së mjeksis familjare dhe të na përgjigjet pyetjeve tona.

Në seancën e kaluar i kam bërë disa pyetje për disa Drejtor që janë këtu por nuk më janë përgjigj, po i përsëris prapë, dua përgjigjie nga Drejtori për Gjeodezi, Drejtori për Shëndetësi dhe nga Drejtori për Administrat të jeni më të përgjegjshëm për pyetjet të cilat ju bëjmë.

Argjend Thaçi: A ka mundësi me i përsërit pyetjet edhe njëherë?

Alban Kastrati: Ju e dini shumë mirë qe ditën e parë Komuna e Malishevës ka bërë shpronësime për me rregullu dhe asfaltu tranzitin dhe e dini që janë procedura ligjore. Rasti që më bie në sy sa herë që kaloj andej është në pjesën që shkon për Carrallukë, në fillim të rrugës kur ka fillu dhe është mbushur me zhavor aty është bërë një ndërtim, dhe kam kërkuar prej Drejtorit me më dhënë sqarime si është e mundur njëher është shpronësu për me u ndërtuar unaza, tani ju është kthyer prap palës ose përsërit privat me ndërtu lokale afariste.

Te shëndetësia, internista kemi pak për momentin, dy intemista kanë dalë në pension Dr.Besim Zogaj dhe Dr. Milazim Kryeziu dhe sa di unë tani është vetëm Dr.Mursel Gashi dhe ky ndoshta së shpejti do të del në pension. Qytetarët e Malishevës nuk kanë internist që të shkojnë me bërë vizita.

Nga Drejtori i Administratës kam kërkuar me na sjell listën e punonjësve që janë me kontrata konsulente, me ditë sa punësime janë bërë gjatë këti mandati, kush janë ata dhe qfarë pune bëjnë.

Argjend Thaçi: Koha e debatit jashtë rendit të ditës ka përfunduar ju faleminderit shumë të nderuar asambleist, tani e ka radhën ekzekutivi që të ju përgjigjen pyetjeve dhe shqetësimeve që i bëtë ju.

Urdhëro, Nënkrjetari Vesel Krasniqi!

Vesel Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Po filloj nga Arlindi, i cili e ngriti një shqetësim i cili me të vërtetë çdo qytetarë e ka këtë shqetësim dhe ne si ekzekutiv sigurisht. Dita e diel ka qenë kulmi i arrogancës së kompanisë KEDS, e cila pa asnjë shpjegim dhe asnjë arsye, vetëm një ditë para që ka lajmruar që deri në ora 15:00 do të jetë rryma e ndërprerë në territorin e Komunës së Malishevës dhe faktikisht ne deri në ora 22:00 nuk kemi pasur kjo i bie 12 orë që nuk kemi pasur rrymë.

Po ashtu dua të i përgjigjem dhe Albanit, i cili tha që nuk kemi bërë ndonjë reagim, reagimi i Kryetarit të Komunës ka qenë dhe përmes portaleve të ndryshme jo vetëm përmes faqes së Komunës së Malishevës, i cili ka ngrit zërin dhe shqetësimin dhe për KEDS-in sigurisht nga dita e hënë, sepse ka qenë ditë e diel atë ditë. Ne kemi kërkuar me email zyrtarë takim urgjent me kreun e KEDS-it, pikërisht për shqetësimet e reduktimeve të rrymës dhe ato që priten në të ardhmen sepse tani do të hyjmë në stinën e vjeshtës dhe dimrit ku gjasat janë të kemi reduktime më të mëdha. Prej asaj dite ne kemi kontakt me drejtorët përgjegjës që kemi mbajtur kontakte rreth kryerjes së punimeve që kemi pasur dhe ja kemi përcjell shqetësimet tona, kemi kërkuar takim urgjent jemi duke pritur një takim të tillë. Besoj që të gjitha shqetësimet e qytetarëve tonë të cilat i kanë me të drejtë do të i pasqyrojmë, dhe do të kërkojmë të jenë më serioz dhe të bëjnë zgjidhje sa i përket qështjes së energjis elektrike.

Kur jemi te vdekja e nënës, motrës tonë shfrytëzoj rastin t'i shprehim ngushëllime familjes në Ngucat dhe në Pagarushë, vërtetë është për me u shqetësu të gjithë, po e kuptoj dhe shqetësimin e juaj. Unë kisha kërkuar që mos ta politizojmë rastin, të i shtrojmë shqetësimet tona aty ku duhet duke filluar nga ne sigurisht tash jemi në një procedurë ku organet e drejtësisë janë duke u marrë me këtë rast. Të gjitha përgjegjësit që na takojnë neve si ekzekutiv jemi të gatshëm para jush dhe para qytetarëve të i marrim ato shqetësime. Ju kisha kërkuar që të paktën në këtë rast të mos bëjmë politikë, sepse Kryetari ka reagu dhe mundem me ja dëshmu. Urojmë që raste të tilla të mos ndodhin më kurrë, jo vetëm në Malishevë por askund. Kjo ka ndodhur nga papërgjegjësia këtë nuk mund ta mohoj askush, 4 persona kanë pasur një leje për një objekt tjetër, para se të hapet ky biznes për të cilën e ushtron veprimtarinë sigurisht organet komunale Inspektoriatit e viziton dhe e cekë që ky ambient apo lokal i plotëson apo nuk i plotëson kushtet. Për lokalin që ka qenë më herët e ka dhënë që i plotëson kushtet, mbi bazën e atij lokali e ka marrë dhe licencën në Minsitrin e Shëndetësisë, pastaj ai ka ndërruar lokacion pa leje dhe tani po dëshmohet se ka bërë dhe punë të tjera të jashtëligjshme. Jemi në kontakt me organet e drejtësisë, organet përgjegjëse dhe do të i mbështesim që dorasit të marrin dënimin e merituar.

Është një shqetësim tjetër që ka javë që ueb faqja e Komunës nuk është duke funksionuar, nuk është duke na ndodhur vetëm neve por të gjitha komunave, është një problem në nivel të vendit sepse ueb faqet menaxhohen nga niveli qendror. Këtë shqetësim përmes asociacionit të Komunave, takimet që kanë pasur zyrtarët e Komunave e kanë ngritur vazhdimisht që është një problem, i kanë bërë disa ndërhyrje dhe prapë është jo funksional e që na ndikon drejtpërdrejt në arritjen e performancës së Komunës. Ne çdo vendim, kërkesë qdo gjë i paraqesim në ueb faqe mirëpo nuk kemi pasur mundësi dhe kjo sigurisht ka me i penalizuar të gjitha Komunitat.

Mungesa e ujit, ju e dini mirë që në sezonën e verës kemi pasur problem, po kanë probleme dhe komunitat e tjera, por secili e ka problemin e tyre. Në këtë rast pajtohna plotësisht që Kompania Hidroregjioni nuk është duke e bërë punën e vetë, dhe pse është e vështirë që të ju ik

reduktimeve. Ne në vitin e kaluar e kemi formuar një taskforcë si ekzekutiv ku kanë qenë pjesë dhe përfaqësuesit e dy kompanive Ekoregjioni dhe Hidroregjioni, Polici të gjitha organet përgjegjëse, dhe i kemi marrë të gjitha masat. Inspektoriati ka bërë punën e tij që vazhdimisht keqpërdoruesit të ndëshkohen. Mirëpo në vitin e kaluar menagjeri është tërhekur dhe që nga ajo ditë nuk kemi menaxher në njësi të Hidroregjionit në Malishevë, sigurisht që janë këto defekte dhe janë këto pasoja. Ne kemi bërë ankesa të ndryshme që është një papërgjegjësi nga ana e Hireregjionit, kemi dërguar shkresa dhe në Hidroregjionin Jugor dhe në nivel qendror. Ne shpresojmë që shumë shpejt do ta bëjnë zgjedhjen e një menaxheri të kësaj njësie dhe të zgjidhen këto probleme.

Te mirëmbajtja e rrugëve dhe demolimet pa leje komunale që bëhen, ne i bëjmë procedurat tona dhe i procedojmë për gjykat, por kjo gjurma qytetare e sheh asfaltin e pren dhe pastaj kërkon mirëmbajtjen. Ne e kemi një kontrat është e pa mundur demolimet të cilat po bëhen faktikisht pas luftës pjesa dërmuese, e dimë me qfarë kualiteti janë shtruar rrugët dhe kanë fillu demolimet e rrugëve thuajse në të gjitha fshatrat. Ne e kemi një kontrat nuk mjafton me i përmbyll të gjitha, por nuk do të ndalemi as këtë vit, as vitin tjetër deri sa të bëhen përmisimet. Ata të cilët kanë bërë demolimet në rrugë qëllimisht janë marrë masa, kemi shumë lëndë në gjykat të cilat sigurisht gjykata do ti ndëshkoj.

Vendosja e shkallëve në trotuar, ne e kemi nxjerr një model të shkallëve metalike që do të jenë anash një metër jashtë lokalit në pronësi publike dhe sigurisht do të ngarkohen me taks Komunale. Ndërsa shkallët të cilat janë në pronësi private kemi kërkuar nga ta që me ja dhënë një pamje të mirë, sepse jemi të pa fuqishëm që të ndërhyjmë në pronën private.

Rreth rrugës "Imer Mullamuqa" ne kemi pasur një takim kemi ngrit një shqetësim, Gjeodezia e ka përfunduar punën e vetë i ka vendos pikat dhe operatori ekonomik ka fillu punimet me i ndërtu, ka hasur në penges, ne vendosëm të njoftohet dhe policia me vendimin e Gjeodezis, sepse personat në fjalë janë duke e shfrytëzua hapsiren publike dhe do ta lirojnë, operatori ekonomik do ta përfundoj punën siq është i planifikuar.

Te mirëmbajtja e bulevardit sigurisht që nuk është ndoshta në nivelin e kënaqshëm, ne kemi kërkuar dhe na është premtuar nga kryeshefi i ekoregjionit që do ta sjelli një makinë e cila do të mirret me pastrimin e bulevardit. Jemi në pritje të saj makine, sepse sa do që të pastrohet në këtë mënyrë sigurisht nuk është në nivelin e duhur, dhe ky bulevard meriton një trajtim më të duhur. Është në procedura përfundimtare të prokurorit të ekoregjionit ashtu na është thënë dhe na po presim.

Te prezenca e Drejtorit nëse pyetjet të cilat ju i ngritni nuk ju ofron ekzekutivi në këtë rast Kryetari, Nën kryetari nuk ju ofron përgjigje, atëherë sigurisht që e ka përgjegjësin Drejtori. Unë mendoj që mjaftueshëm mundet me përfundu dhe Kryetari dhe Nën kryetari nëse kërkohet në mënyrë profesionale për diqka tjetër përtej kësaj ndoshta dhe vet Drejtori do të ju drejtohet me shkrim në mënyrë profesionale.

Sa i përket pyetjes se a kemi stomatolog, po kemi mjaftueshëm dhe orarin e punës e kanë 07:00-15:00, dhe mendoj që është duke u zbatuar ky orar. Por kjo ndodhë në mënyrë vullnetare dhe nuk mundesh me i tregu askujt se ku të shkojë të bëjë një kontroll.

Ndërtimi i objektit në tranzit ne nuk i kemi dhënë leje operatorit ekonomik, përderisa ka qenë kompetencë e Ministrisë së transportit dhe ambientit. Shpronësim nuk është bërë e që e ka pengu dhe ekzekutimin e punimeve ku bëhen, personi në fjalë ka kërkuar nga ne leje që të ndërtohet, ne nuk i kemi dhënë leje fillimisht, sepse pa lëvizur Ministria e cila është kompetente për atë pjesë ne jemi të pafuqishëm. Një gjë e tillë ka ndodhur nga Ministria, ju i keni parë dhe video injjizimet dhe pasatj i ka plotësuar kushtet e objektit dhe e kemi pajisur. Hartimi i projektit është

kompetenc dhe është bërë nga niveli qëndror nga Ministria e transportit, investimi, kontrata janë bërë nga po kjo Ministri. Punimet kanë fillu me urdhnin, përkuqdesjen dhe menaxhimin e kësaj Ministrie, procedurat ligjore do të duhej që para se me ardhë te fillimi i ndërtimeve të bëhet shpronësimi i pronave, dëgjimet publike dhe pastaj të fillojnë punimet, një gjë e tillë nuk ka ndodhë, kanë ndodhur vetëm punimet. Komuna në këtë rast është e pa fuqishme sepse është krejtësisht kompetenc e Ministris së transportit dhe ambientit.

Te lista e puntorëve, bëne një shkresë me shenim dhe mundemi me ti sjellë të gjithë emrat të cilët janë duke punuar, sepse ajo është publike.

Internistata është ligj i cili ka me na penalizu ne dhe gjithë qytetarët e Kosovës sepse në të ardhmen nuk lejohet internistat të mirren me nivelin lokal. Këto janë përgjigjet faleminderit të gjithëve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtori Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Dua të jap sqarime për qështjet që ngritën për sektorin të cilin e menaxhoj unë, sa i përket qështjes së liritimit të hapsires publike në fshatin Turjakë ne kemi marrë disa veprime, kemi konstatuar gjendjen në teren dhe hapsiren publike që shfrytëzohet në mënyrë të kundërligjshme dhe kemi marrë vendim dhe personit ja kemi dërguar vendimin që ta lirojë atë. Me sa kam parë nuk ka bërë ndonjë lëvizje kështu që nëse këto paraqiten pengesa për realizimin e rrugës unë besoj që do të realizohet vendimi dhe do të lirohet hapsira.

Qështja tjetër kërkesat dhe shqetësimet të cilat i ka ngrit që te fondacionit nuk kanë hasur në mirkuptim, unë nuk e di qfarë kërkesa kanë bërë fondacioni, tani e keni krijuar këtë fondacion kështu që nëse keni ndonjë kërkes që lidhet me sektorin tim unë besoj që do ta trajtojmë.

Qështja tjetër e ndërtimit në tranzit, Alban komplet projekti dhe shpronësimi është kompetenc e Ministris për arsye se dhe Komuna ka shumë problem me bërë shpronësimin e të gjitha atyre pronave të cilat i prek ndërtimi i tranzitit. Është bërë projekti janë caktuar vijat, mirëpo nuk kemi asnjë vendim që është ardhë dhe e precizon që këtë pronë do ta merr tranziti, përveq vijave të cilat i kemi dhe në bazë të atyre vijave orientohe mi se cilat prona i prek. Në rastin në fjal ne kemi pasur dhe intervistë në televizion ku e kemi specifiku që një pjesë e tranzitit është zhvendos, me dokument është ardhë nga Ministria se ajo pjesë e tranzitit ka lëvizur me qëllim që me ja mundësu personit në fjalë kërkesën pra ndërtimin e objektit. Ne nuk kemi qfarë të bëjmë, nuk është bërë shpronësimi pronat janë private ashtu siq kan qenë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar dhe Drejtor për sqarimet të cilat i dhatë në lidhje me qështjet të cilat i bënë anëtarët e Kuvendit.

Konstatoj që 26 anëtarë jemi prezent, mungesën e ka konfirmuar Agnesë Kastrati dhe Valon Krasniqi. Kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë punimet.

Kalojm te rendi i ditës, kemi një pikë nga zyra e Kryetarit, kërkesa nr.01/1149. Kërkes për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës bazuar në ligjin nr. 03/L-0/40 për vetë qeverisjen lokale në Republikën e Kosovës, neni 7 Statuti i Komunës së Malishevës, neni 8 paragrafi 8 pika 3, para jush propozoj iniciimin e procedurave ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës.

Në lidhje me këtë qështje hapi parë propozoj që të formohet Komisioni i cili do të kujdeset për zhvillimin e procedurave ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës. Komisioni do të bëjë thirrje publike për shprehje të intresit për persona fizik dhe juridik kompetent, që të i ofrojnë propozimet e tyre në bazë të kriterëve të cilat do të përcaktohen

nga Kuvendi i Komunës. Pas përfundimit të gjithave qështjeve procedurale nga ky Komision, si dhe pas konsultimeve publike tri propozimet do të parashtrihen para jush dhe vetëm një do të votohet dhe përcaktohet me vendim skema zyrtare e Komunës së Malishevës. Ky propozim ka rrjedhë si rezultat i kërkesave të vazhdueshme nga qytetarët e Komunës së Malishevës, por dhe për arsye se skema aktuale ka ngjashmëri të përafërta dhe me skema të Komunave të tjera, dhe po ngjallen debate të ndryshme me skemën e Komunës së Malishevës. Është një kërkesë e kryetarit që të futet në kuadër të pikave të rendit të ditës.

Kush është për që kjo kërkesë të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Për: 25

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime kjo kërkesë hynë si pikë në rend të ditës.

A e dëshiron fjalën dikush për rend të ditës?

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në seancën e kaluar i kemi pasur dy kërkesa të qytetarëve, me ju dhënë në shfrytëzim një pronë publike. Kërkesa e Arijon Krasniqit dhe Adem Hotit, të cilat i kemi shtyrë për seancën e radhës që i bie për këtë seancë për me i dhënë epilog, e kemi parë që është pak problem në aspektin ligjor dhe këto dy kërkesa janë kryesisht humane dhe të dyja janë raste specifike të cilat e dojnë ndihmën e institucioneve në këtë rast Kuvendit Komunal të Malishevës. Kërkoj që këto dy pika të hyjnë në rend të ditës, dhe me një vendim ta shprehim vullnetin e mirë për me ju ndihmu dhe aspektin ligjor ta shqyrton MAPL-ja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Unë kam dy qështje e para kërkoj që miratimi i Statutit të heket si pikë e rendit të ditës, këtë gjë e kam kërkuar dhe në KPF. Besoj që si Komision e kemi bërë një punë shumë të mirë, mirëpo pasi që jam anëtarë i komisionit nuk e di saktë sa mbledhje i kemi mbajtur, besoj që secilit anëtar i ka kushtuar kohë dhe mund me ardhë dhe ne nuk jemi kompenzuar për atë punë që e kemi bërë. Mendoj që Drejtoria e Financave duhet me qenë më e përgjegjshme në këtë aspekt, pa i përfunduar obligimet ndaj secilit anëtarë, unë kërkoj të mos miratohet. Dhe kërkesa e cila erdhi për ndërrimin e stemës është e inkorporume në Statutin e ri të Komunës, mendoj që është shumë e arsyeshme me u shty kjo pikë.

Qështja tjetër e cila kërkoj të hyjë në rend të ditës është qështja vendimi i Ministris së Financave për faljen e borgjit të tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Malishevës. Ju e dini që ekziston një vendim dhe është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për me u zbatu duhet me marrë miratimin e Kuvendit Komunal. E mira e kësaj është se dhe ata të cilët e kanë paguar tatimin në pronë ju kompenzohet si avanc për vitin që vjen, dhe nuk paguan. Unë mendoj që është e rëndësishme të hyjë si pikë në rend të ditës me u trajtu dhe pastaj secili grup politik të jep mendimin dhe votën që dëshiron.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë!

I bashkangjitem kërkesës së Halilit që të hyjnë si pikë e rendit të ditës kërkesat e qytetarëve. Kërkesat për dhënie të pronës është mirë ti Kryesus me i ndal me fillim, sepse ne po e votojmë, po bëjmë politikë dhe ajo në realitet nuk ndodhë kurrë, sepse MAPL-ja e kthen përgjigje negative, më mirë kishte me qenë me gjetë një formë tjetër se si duhet të i jipet një pronë dikujt me ndërtu një shtëpi. Ka shumë kërkesa të vonuara keni parasysh, sidomos KPF-ja dhuroni

përparësi njerëzve të cilët kanë nevojë, por mos të shkojmë në baza politike dhe interesa personale të dikujt.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nënkrjetar!

Veseli Krasniqi: Po lidhna te propozuesi i cili e kërkoj të largohet si pikë e rendit të ditës dhe të shtyhet për seancën e radhës pika miratimi i Statutit të Komunës, kisha kërkuar që mos të priset kjo frymë. Kërkesa e juaj është legjitime dhe e drejtë, një prej takimeve unë e kam marrë përgjegjësin që obligimet do të përfundohen dhe kam biseduar, e kemi trajtuar kemi vendosur me Drejtorin që do të përfundohen të gjitha obligimet dhe të Komisioneve të tjera. Nëse është i vetmi fakt që të shtyhet për arsye të mos pagesës, kisha kërkuar mirëkuptim që sot të diskutohet Statuti dhe të vazhdohet tutje. Si Nënkrjetar jam përgjegjës që obligimet do të përfundohen për të gjitha Komisionet, në veqanti për Komisionin i cili ka punuar rreth ndryshim plotësimi të Statutit. Qështja tjetër kërkesa e cila erdh nga Kryetari nuk lidhet ndryshimi i Statutit me emblemen e Komunës, ne e kemi një emblem ne po bëjmë plotësim ndryshim të neneve duke u inkorporu të gjitha plotësim ndryshimet e ligjeve të cilat janë bërë në Kosovë. Po e sqaroj këtë punën e stemës se si shkon, sot formohet një Komision nga asambleja Komunale, me përfaqësues të grupeve që ju e formoni, është mirë të ketë një nga zyra e Kryetarit dhe një nga OJQ shoqëria civile si ekspert i fushës së caktuar. Ky komision pas hulumtimeve do të nxjerr detyrat projektuese, dhe pastaj do ta sjell në asamble komunale së bashku me tri qmime, të cilat do të ndahen qmimi i parë, dytë dhe i tretë së bashku me vlerat. Pasatj do të votohen detyrat projektuese të cilat pastaj kur të kalon nga asambleja do të bëhet thirrja publike, ku aplikuesit do të bazohen mbi bazën e këtyre detyrave projektuese. Në fund sjellet me u votu me 2/3 e asambles, kjo është procedura e cila kërkohet. Deshta me sqaru dhe Vetonin që stema është me vendim të veçant nga plotësim ndryshimi i Statutit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Meqë e kemi një qështje të rëndësishme që është ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Malishevës, unë nuk kisha thënë që për qështje të pagesave të shtyhet kjo pikë, për arsye se është një qështje shumë e rëndësishme. Sa i përket qështjes së pagesave, Vetoni, është e vërtetë u bënë dy vite që 10-15 Komisione nuk janë paguar. Po të premtoj që prej seancës së ardhshme do të bëjmë bojkot total të qfarë do lloj pike nëse ekzekutivi nuk ndërmerr masa për pagesa të këtyre Komisioneve.

Qështja tjetër nëse hynë në rend të ditës ndryshimi i stemës, duhet të hyjë dhe si pikë e rendit të ditës formimi i Komisionit për ndryshim të stemës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Përsëndetje për të gjithë!

Si anëtare e Komisionit unë e di që ka qenë në dëgjime publike Statuti i Komunës, e dimë që aty japin vërejtje dhe propozime nga qytetarët. Si anëtare e Komisionit unë kam prit që mbas dëgjimeve publike, të na ftoni dhe të i shohim se çka kanë propozuar qytetarët në lidhje me ndryshim Statutin e Komunës së Malishevës. Ne nuk jemi kontaktuar, nuk jemi thirrë kjo ka qenë një nga arsyet që ne sot mos me pas në rend të ditës këtë pikë. Te pagesa normal që të gjitha punët duhen të paguhen, por nëse jemi keq presim.

Argjend Thaçi: Ne e kemi pasur datën e dëgjimit publik në asamble, ti nuk ke qenë. Pjesëmarrja nuk ka qenë e kënaqshme prandaj nuk e kemi vazhduar dëgjimin publik, nuk ka pasur të interesuar. Nuk ka pasur rekomandime, përveq që lagjia Mekaj të futet në kuadër të lagjeve të

Malishevës, atë paraprakisht si Komision e kemi bërë. Nëse do të kishte pasur rekomandime patjetër që ne si Komision do të duhej ta kishim bërë riharmonizimin e të gjitha atyre rekomandimeve të cilat kanë ardhur.

Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Është dashur të thirret Komisioni dhe një herë, në fund të i japim të gjithë nënshkrimet tona dhe të sjellet në asamble.

Argjend Thaçi: Nënshkrimi është vetëm për pjesmarrje.

Urdhëro, Nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Herën e fundit kur keni votuar është votu me të gjitha plotësim ndryshimet dhe në total e kemi votu plotësim ndryshimin e Statutit si Komision për të i dhënë hapsirë dëgjimeve publike. Dëgjimin publik kur e fton ti e përfundon përgjegjësin ligjore, mos pjesëmarrja nuk e bënë shkeljen procedurale, nëse gjatë periudhës dëgjimore jo vetëm debat por dhe në mënyrë elektronike dëgjimi publik ka qenë i hapur dhe përderisa nuk ka pasur asnjë sygjërim atëherë ne kemi votu faktikisht në fund me plotësim-ndryshime Statutin si Komision. Te propozimi i Vetonit për futje në rend të ditës vendimin e Ministris së Financave për falje të borgjit të tatimit të pronës, jemi në procedurë të cilat Komunat përmes asociacionit i kanë ngrit shqetësimet e tyre dhe ky ligj është dërguar në gjykatën Kushtetuese, por përderisa nuk kemi një masë të parakohshme munden me procedu, munden dhe mos me procedu. Ne kemi afat kohor dhe mendoj që sot nuk e kisha fut si pikë të rendit të ditës për diskutim, për faktin që jemi në kohë. Sigurisht që jemi për me zbatu ligjin, por mendoj që mbrenda kësaj periudhe që jemi në afat me ligjin do të kemi diqka.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Vetëm deshirova të ndërlihem te qështja e ligjit për tatim në pronë nëse nuk gaboj data e fundit është 15 shtator dhe nuk besoj që mbajmë seancë para 15 shtatorit. Është mirë me ju dalë në ndihmë qytetarëve.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Tri emaila janë duke më ardhur sqaruese, ka ardhur ligji i faljes së tatimit në pronë deri në 100E, emaili tjetër ka ardhur se është në dorë të Komunave caktimi i shumës sa duhet të falet deri në 100E që i bie ti mundesh me ja falë dhe 10E, pastaj ka ardhë emaili i tjetër jo të gjitha falen psh. një person është i ngarkuar me tatim në pronë për tri objekte të bëhen bashkë dhe të ju falet 100E tatim për të triat. Është një konfuzitet, jemi duke pritur sqarime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Nuk pajtohem me Drejtorin Blerim që e ceki që kështu do të jetë vendimi i gjykatës, gjykata nuk ka vendos siguri për këtë ligj dhe është dhe arsyetimi i Labinotit i cili e ceki që nuk besoj që do të mbahet mbledhje para 15 shtatorit. Nëse gjykata kushtetuese e kthenë të jashtëligjshëm nuk e zbaton si vendim.

Argjend Thaçi: A jeni të gatshëm me caktu një seancë të jashtëzakonshme për ndryshim plotësim të Statutit që ta mbajmë një takim siç e ceki Mirëllinda për me i shqyrtu ndëgjimet publike të cilat janë bërë.

Kalojm te propozimet për rend të ditës, kërkesa e Veton Zogaj: Vendimi i Ministris së Financave së transfereve për falje të tatimit në pronë që të hyjë si pikë e rendit të ditës. Kush është për?

Për: 2

Kundër: 13

Abstenim: 12

Me 2 vota për, 13 kundër dhe 12 abstenime kjo kërkes nuk hynë si pikë e rendit të ditës.
Vazhdojmë me kërkesën e Halilit për pikat e seancës së kaluar të cilat i kemi shtyrë për një seancë tjetër dhe arsyetimi ka qenë që të gjindet një modalitet. Unë si Kryesus nuk kam mundur me gjetë ndonjë modalitet, dhe nuk e kam parë të arsyeshme të futen si pika të rendit të ditës në këtë seancë. Kërkesa për dhënie të pronës për z.Adem Hotin dhe Arijon Krasniqi. Kush është për që kërkesa 01/385 datë: 14.03.2023 e parashtruar nga Adem Hoti të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Për: 19

Kundër: 3

Abstenim: 3

Me 19 vota për, 3 kundër, 3 abstenime kjo kërkes hynë si pikë e rendit të ditës.
E kemi dhe kërkesën 02/637 nga Arijon Krasniqi. Kush është që kjo pikë të hyjë si pikë në rend të ditës?

Për: 20

Kundër: 2

Abstenim: 4

Me 20 vota për, 2 kundër, 4abstenime edhe kjo kërkes hynë si pikë e rendit të ditës.
Draft Statuti i Komunës së Malishevës, të largohet si pikë e rendit të ditës sipas kërkesës së Vetonit. Kush është për?

Për:12

Kundër:15

Abstenim: 0

Me 12 vota për, 15 kundër, asnjë abstenime kjo pikë mbetet si pikë e rendit të ditës.
E hedhim në votim rendin e ditës si tërësi me plotësim dhe ndryshimet e bëra. Kush është për këtë rend të ditës?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 12

Me 15 vota për, asnjë kundër, 12 abstenime miratohet ky rend i ditës.
Vazhdojmë së pari me kërkesën e Kryetarit, kërkesa nr.01/1149. Kërkes për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës. Për këtë duhet të formohet dhe Komisioni që duhet të jetë nga të gjithë anëtarët e subjekteve politike nga një përfaqësues, nga zyra e Kryetarit një përfaqësues dhe një nga shoqëria civile. A jeni të gatshëm grupet parlamentare me i propozu emrat?
Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Si anëtar të Komisionit për ndryshimin e stemës së Komunës ne e propozojmë Valon Mazrekun.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Kastrati!

Nebih Kastrati: Ne e propozojmë Burim Paqarizi.

Argjend Thaçi: Nga VV-ja, Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne propozojmë Arbnore Hoti.

Argjend Thaçi: Nga AAK-ja?

Donjeta Shijaku: Nga AAK propozojmë Eqrem Morina.

Argjend Thaçi: Nga LDK?

Arlind Morina: Nga LDK nuk ka emër për momentin.

Hamit Lima: Unë propozojë Driton Kastratin.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim kush është që Komisioni të jetë në përbërje prej shtat anëtarëve Valon Mazreku, Burim Paqarizi, Arbnore Hoti, Eqrem Morina dhe Driton Kastrati si dhe një anëtarë nga zyra e Kryetarit dhe një ekspert nga shqëria civile. Kush është për?

Për: 23

Kundër: 3

Abstenim: 0

Me 23 vota për, 3 kundër dhe asnjë abstenime formohet Komisioni.

Vazhdojmë në pauzë deri në ora 13:00.

Të nderuar anëtarë të kuvendit jemi në vazhdimin e pjesës së dytë pas pauzës. Vazhdojmë me pikën: Shqyrtimi dhe miratimi i draft Statutit të komunës së Malishevës. Ftoj grupet parlamentare që ti dhëjnë qëndrimet e tyre për këtë pikë të rendit të ditës.

Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Kjo është një pikë që kërkon dakordim të 2/3 të anëtarëve të kuvendit, dhe për neve si NISM nuk është problem që me u trajtuar në një seancë të jashtëzakonshme, nëse nuk kanë qëndrim grupet tjera që me u trajto sot.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Dhe ne si grup parlamentar jemi në qëndrimet tona që kjo pikë mos të jetë në rendin e ditës dhe as të diskutohet, të shtyhet në një seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Kush është për, që pika për draft Statutin të shtyhet për një seancë tjetër?

Me vota unanime, kjo pikë shtyhet.

Pika radhës shqyrtimi i Raportit të DKAË-së për fillimin e vitit shkollor 2023-2024. Raportin e keni dhe mundemi me diskutu pastaj vjen dikush nga drejtoria e arsimit. Po vazhdojmë me pikën e radhës deri të vjen dikush nga drejtoria e arsimit. Pika e radhës është shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor të Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023. Për këtë pikë prezent e kemi Drejtorin për Bujqësi.

Urdhëro, drejtor!

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë!

Raporti gjashtë mujor pasqyron pjesën më të madhe të aktiviteteve të Drejtorisë së Bujqësisë. Si pika të shkurtëra është bërë përkrahja e blektorëve me subvencionim të qumshtit përmes pagesave direkte me litër qumsht 0.03 cent. Kemi subvencionimin e fermerëve me pagesa

direkte për delet dhe dhit që kësaj here ka qenë nga 3 euro. Kemi bërë një marrëveshje për subvencionim të përbashkët për përkrahjen e fermerëve përmes organizatës Katar, në të cilën ka ndodhur vlerësimi i aplikantëve për të përfitu mekanizëm bujqësor dhe sera. Për sera në momentin që po flasim është duke mbajtur komisioni takime të rregullta në Prishtinë, ne e kemi një përfaqësues dhe ata janë 2-3 anëtarë. Në kohën që po flasim janë duke raportuar që po aplikuar për pjesën e plehit dhe pjesën e grurit kg 0.3cent. Kemi pasur punë dhe në teren për dëmet që janë shkaktuar në bujqësi për shkak të reshurave sidomos në muajin qeshor që janë dëmtuar më shumë pemishtet në komunën tonë. Kemi filluar subvencionimin për dele dhe dhi, një sektor mjaftë i ndishum dhe jashtëzakonisht ka pasur efekt, të gjithë kanë aplikuar dhe rreth 15.000euro janë ndihmuar. Te përkrahja fermerëve që e përmenda përmes Katar, ne kemi përfutur 50 sera të cilat janë në një sipërfaqe 96m. Aktivitetet tjera që janë i kemi pasur për aplikimet që i kanë bërë për subvencionimin dhe grurit nga ministria dhe për qumsht. E kemi pasur një presion të jashtëzakonshëm në atë periudhë kohore. Sipërfaqja e kulturave të mbjella tek ne ka qenë më e mirë se vjet. Grurë kanë qenë 76 fermerë me sipërfaqe 2821h, misër 388persona me 1052 h që është një rritje enorme e mjelljes me misër, tërshër 42 perona me 94h, elb 10h janë 7 persona. 12% e kemi pasur sipërfaqen më të mbulume se vitin e kalim. Pjesa tjetër është e faktume me foto me fermerët. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Unë e kam lexuar këtë Raport dhe nuk kam as me shtu as q me heq, mirëpo desha ta falenderoj drejtorin për kontributin që është duke e dhënë në këtë dikastier dhe është duke e dhënë gjithë potencialin e vetë. Projektet po i shohin çdo ditë dhe është shembull drejtori Dukolli se si duhet pranuar përgjegjësia dhe si duhet të punohet në interes të qytetarëve. Drejtor, të përgëzoj dhe kisha bërë thirrje që dhe drejtorët e tjerë ta marrin shembullin e drejtorit Dukolli. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Faleminderit, drejtor dhe për Raportin dhe për laborimin e këtij Raportit këtu para nesh. Raportet që i bënë drejtorja e bujqësisë përkatësisht drejtori i përmbushin të gjitha kriteret standartet për të qenë një raport. Me një dinamikë dhe me efikasitet kjoja të madh dhe me aktivitet drejtorja e bujqësisë po i kryen detyrat e veta që janë të parapara sipas programit. Ajo qka është e rëndësishme me u theksu te ky raport, një drejtori e mirë dhe një drejtor i mirë nënkupton që me atë buxhet të vetin që e ka e implementon siç duhet, por nëse ky drejtor ose ky ekzekutiv përveq buxhetit të vetë që e ka, gjenë dhe forma të financimit përmes donacioneve përmes organizatave të vendeve të ndryshme kjo pasqyron më shumë një Drejtor, një Kryetar të Komunës së mirë kjo i bënë super të mirë. Pra me ja shtu Komunës 1 milion euro Komunës së Malishevës nënkupton me ja shtu 30% buxhetin total që e ka Komuna për investime kapitale. Unë të inkurajoj Drejtor për vazhdimin e punëve siq je duke i bërë dhe për ruajtjen e partneritetit me këtë organizatë dhe me përpjekjen me gjetë dhe forma të tjera të financimit. Meqë Komuna jonë është një Komunë kryesisht blegtorale dhe bujqësore, sa më shumë me u rrit buxheti dhe financimi i blegtorëve dhe bujqëve kjo është e vetmja mënyrë me zhvillu ekonominë e Komunës tonë. Ju përgëzoj për punën që po e bëni. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Faleminderit Sylë për raportin, ish bërë një punë e mirë uroj që të vazhdoni kështu dhe të kisha inkurajë që te delet dhe dhitë ta bëni një maksimum sepse dhe terrenin e kem të tillë që njerëzit të mirren me këtë fushë, është aq profitabile dhe të njëjtën kohë është e mirë dhe për Komunën. Qumështi i dhive ka dalje shitje, te qumështi është përparsi sepse Katari e subvencionon këtë pjesë është e mirë për bujqit, në të njëjtën kohë rritja e dorzimit të qumështit është vlerë për Komunën tonë sepse ne jemi vend bujqësor.

Te vreshnat, a ka rritje të mbjelljes së vreshnav?

Më intereson me ditë sepse një pjesë e madhe është dëmtu është mirë kjo pjesë të konsiderohej. Mbi të gjitha keni një raport pozitiv me krahasuar me raporte të tjera, nuk do të thotë që nuk ka dhe mangësi, qdo raport i ka përparësit dhe mangësit e veta. Uroj që të jeni të fokusuar te bujqit dhe jo te votat sepse kjo është puna që ju dhe ne do ta bëjmë.

Mendoj që në buxhetin e shtatorit që do votohet të i japim hapsirë më shumë, të kërkojsh mjete fond dhe ne jemi për të mbështetur në kuvend që ta rritësh buxhetin për bujqit. Mendoj që disa rekomandime kanë munguar për vjeshtë në fund të raportit, për me pa se qfarë ke synuar për mbjelljet vjeshtore të cilat janë të grurit. Kisha pasur dëshirë ta dije planifikimin tënd se në qfarë forme do të i mbështesësh ata.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Nëse nuk gaboje i kanë sjell dy apo tri kërkesa në mbledhjet e më hershme në KPF, kanë qenë për dëme të cilat u janë shkaktuar, që ju kanë asgjësuar bagëtisë për arsye të një sëmundje të cilave ju është shfaqur. Dëshirova me ditë a është mbështetur nga Ministria fermeri në fjalë?

Kanë qenë dhe tri kërkesa të tjera për mbështetje të bujqëve të cilët ju kanë dëmtuar kumbullat, mollat për arsye të reshurave a janë mbështetur këta fermerë?

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka dikush tjetër për diskutim, fjalën ja dhë Drejtorit për tu përgjigjur në qeshqesh të cilat i bënë asambleistat.

Urdhëro, Sylë Dukolli!

Sylë Dukolli: Faleminderit për fjalët e mira por dhe me kritika kënaqem, sepse në raportin tjetër jam më i saktë.

Sa i përket pyetjes për vreshta, realisht unë pres që me qenë dikush premtues për grande në Komunën tonë sepse vetëm përmes grandeve po shtohet sasia e vreshtave. Kjo lami nuk po është profitabile sipas tyre, kamë marrë pjesë në tri apo katër seminare dhe e kam ngre qeshqeshin që vendi jonë është vend i cili ka pasur një kulturë të mirë me kultivimin e vreshtave, dhe kanë thënë që ta shitin këtë pjesën private. Bujqit nuk po kanë se ku ta dorzojnë profitin për arsye të qmimit që kam dëgjuar që ka qenë 8cent.

Sa i përket dëmeve sa herë që i kaloj raportet në asamble nuk i kaloj për drejtori timen por për Ministri për Komisionin qëndror. Ka muaj që e kam kërkuar, pjesën e parë e kemi kaluar këtu dhe pjesën e dytë e kam kaluar jam duke e hartuar një projekt e kompletoj dosjen për me dërgu, dhe jam në kompletim të dosjes për dëme të dyta. Për të parin nuk më kanë thirrur me shqyrtu apo me u konsultu dhe nuk i kanë thirrur asnjë anëtarë të Komisionit tonë të cilët i kemi pasur në teren për vlersim të këtyre dëmeve.

Sa i përket familjes në Lubizhdë ja kam kaluar një vlerë prej 4.000.00E, fermerit ende nuk i kanë dalë në llogari, mirëpo është e aprovuar dhe tash është qeshqesh financiare.

Argjend Thaçi: Kalojmë te pika e radhës e cila është: Shqyrtimi i Raportit të DKAE, për fillimin e vitit shkollor 2023/2024.

Urdhëro, Drejtoreshë Arbëresha Krasniqi!

Arbëresha Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Ju falenderojë për bashkëpunimin secilit prej jush!

Shumica prej juve jeni në sferën e mësimdhënies dhe i keni formacionet bazike se si funksionon arsimi në Komunën e Malishevës, gjë për të cilën më gëzon fakti që jam para jush me prezantu dhe me diskutu për qështje të ndryshme të cilat më shërbejnë mua, dhe ju shërbejnë fëmijëve të Komunës së Malishevës. Personalisht jam shumë e angazhuar për përmisimin e gjendjes në arsim e them shpirtërisht, nuk jam kursyer në asnjë mënyr. Jam munduar shumë me qenë afër shkollave dhe stafit mësimdhënës dhe njëkohësisht kemi bërë dhe realizimet të projekteve të cilat kanë ndihmuar në përmisimin e sistemit të funksionimit të arsimit në Komunën e Malishevës. Po ndihem mirë që jemi konkurent me Komunitat të cilat janë më të mëdha, kanë buxhet më shumë dhe sigurisht kanë mundësi më të mëdhaja.

Ndjehem

mirë dhe në raport me Komunitat të cilat dhe stadin e zhvillimit akademik dhe arsimor e kanë më lartë se na. Mirëpo nuk do të thotë kjo që ne nuk kemi vend dhe mundësi dhe ide të cilat na ndihmojnë që ne të përmisohemi. Ne kemi vend për përmisim, kemi planifikim dhe ide që arsimin ta funksionalizojmë, dhe ta bëjmë më të mirë në Komunën e Malishevës.

Besoj që aktivitetet për gjatë muajve i keni të cekura këtu nga muaji janar dhe muajt me radhë, ajo që është shqetësuese për mua është lëvizshmëria e fëmijëve në vendet e Evropës i cili është një numër shumë i madh.

Është shumë shqetësuese dhe lëvizja e mësimdhënësve në drejtim të shtetëve të Evropës. Unë e them me përgjegjësi të plotë qdo mësimdhënës që ka ardhur dhe ka kërkuar me shku jashtë Kosovës, asnjëri nuk e ka thënë që e lë punën në arsim për arsye të pa mundësis së funksionimit si mësimdhënës e pa mundësive që i ka ofru Komuna dhe faktorëve të tjerë, por po e lë mësimin për një jetë më të mirë të fëmijëve dhe pasardhësit e tyre. Këto janë këto përgjigjet të cilat i kanë dhënë mësimdhënësit të cilët kanë lëvizur nga Kosova në vendet e tjera të Evropës.

Fokusi kryesor ka qenë funksionalizimi i dy qerdheve në Komunën e Malishevës, dhe jemi pothuajse në finalizim të saj, i kemi bërë pranimin e dokumentacioneve të fëmijëve të cilët kanë shprehur gaditshmërin me qenë pjesë e qerdheve. Puna është duke u bërë aty, akomodimin do ta kenë sigurt, kontratën për ushqim dhe një kohësisht dhe kontratat tjera i kemi të kontraktuara. Ne e kemi bërë pranimin e stafit të punonjësve në dy qerdhe dhe e them me përgjegjësi të plotë që janë ndër më profesionalet të cilët ju kanë nënshtruar testit dhe intervistës, por ka dhe të tjerë të cilët i kanë plotësu kushtet dhe kriterët por jo dhe në nivelin e duhur të rezultateve të testit apo intervistës me gojë.

Rezultatet e testit të arritshmëris ju i keni para vetës, i keni të potencuara prej të -I- deri në të -IX- dhe prej -X- deri -XII-. E them që është në lëvizje në drejtim pozitiv të rezultatit të testit të arritshmëris dhe të testit të maturës, jo ai që ne dëshirojmë por është pak një sinjalistikë që na dërgon në drejtim të përmisimit të rezultatit të nxënësve.

Argjend Thaçi: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Gentianë Hoti!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Pasi që jemi te kjo pikë ju uroj të gjithëve një fillim të mbarë shkollor, edhe pse mendoj që ky vit do të jetë më i vështirë se sa vitet e tjera për arsye se kemi vështirësi me tekstet shkollore. Kjo ka krijuar shumë vështirësi dhe te prindërit për aplikimin e E-Kosovës ku duhet të aplikojnë.

Drejtoresh kam disa pyetje, pasi që kam parë në media që e keni mbajtur një takim me Ministrinë e Arsimit, qfarë është diskutuar në atë takim?

A do të fillojë mësimi me 1 shtator dhe nëse po si do të filloj pa tekste shkollore pasi që numri i aplikuesve është shumë i ulët?

Si do të bëhet furnizimi ose aplikimi për tekste shkollore për nxënësit e klasave të -I- , pasi që nxënësit të cilët nuk i kanë mbushur 6 vite deri në muajin gusht ata nuk mund të aplikojnë?

Si e ka paraparë znj.Nagavci, a ju ka dhënë ndonjë shpjegim se si do të punojnë nxënësit prej klasës së -VI- deri në klasën e -IX- me libra të plotësuar?

A e din ajo se ka libra të punës, të cilat kur të plotësohen njëherë nuk mundesh me punu më në ato libra?

Mendoj që znj.Nagavci dhe Arsimit janë shumë larg njëra tjetrës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Faleminderit Drejtoreshë për laburimin e raportit që na bërë!

Siç thashë për raportin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe ky raport i Arsimit po i plotëson të gjitha kushtet dhe standartet të cilat duhet me i pas një raport. Dua të përqendrohem te aktivitetet të cilat Drejtoria e Arsimit i ka pasur për gjatë muajve të ndryshëm.

Është një numër shumë i madh i aktiviteteve, duke pasur parasysh që dhe drejtoria ka një numër shumë të kufizuar të zyrtarëve apo punëtorëve dhe me një numër kaq të vogël puntorësh me i përmbledh dhe me i realizu të gjitha këto aktivitetet të cilat janë të duhura për Drejtorin e Arsimit. Siç e ceki dhe Gentiana, shqetësimi më i madh i imi është pjesa e cila ka të bëjë me përgaditjet e vitit shkollor 2023-2024, përveq kësaj problematike të teksteve shkollore që është shkaktuar një krahur e madhe për realizimin e tyre dhe ju ka nxjerrë një numër të madh të problemeve prindërve, për me i siguru librat ku deri më tani ai proces ka qenë shumë i thjeshtë. Janë shkuar nxënësit i kanë marrë librat në shkollë dhe kanë filluar procesin shkollor. Prindërit nuk kanë pasur arsye me u shqetësu për këtë punë, dhe nuk kanë pasur nevoj me i humb ditët e veta të punës me u marrë me këtë qështje. Kanë me dalë shumë probleme dhe me llogarit bankare, sepse një pjesë e madhe e qytetarëve kanë minuse në banka dhe në momentin që dalin ato para të teksteve shkollore ka me ju marrë banka, për arsye vështirësive financiare një pjesë e mirë e qytetarëve ato mjete munden me i shfrytëzu për gjëra të tjera të cilat janë më të domosdoshme për ta. Kjo është shqetësuese për secilin ky lloj i sigurimit të mjeteve shkollore, e ceki dhe Drejtoresha që sfidë është ikja e nxënësve me të vërtetë është sfidë e madhe. Por na kemi fillu me u përballë me një sfidë tjetër e që është ikja e mësimeve, me këtë gjendje me këtë inflacion që ekziston dhe që me gjasë nuk do të bjerë kurrë vetëm do të ngritet, e kanë të pamundur

punëtorët e arsimit mbijetesën me këto paga të cilat i kanë. Ata janë duke e pritur momentin e duhur me u largu nga ky vend dhe ka me u bërë më shumë problem kur ne kemi me pasur mungesë të mësimdhënësve. Është me të vërtetë rrezik i madh me u rrënu këto institucione publike qoftë adminitrata, arsim, shëndetësi, të cilat janë ndërtuar gradualisht dhe po dëshirojnë me u shkatërru shumë shpejtë nëse vazhdohet kështu. Shpresoj duke llogarit angazhimin dhe aktivitetin të cilin po e bënë Drejtoresha, me i përcaktu punët të paktën ato qka janë të domosdoshme me mbarvajtë mësimin ashtu siq duhet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Faleminderit Drejtoreshë për raportin!

E kam analizu dhe i kam nxjerrë disa qështje të cilat i kam parë që janë të rëndësishme me i ngrit si shqetësime. E para ka të bëjë me braktisjen e shkollave me numër 592 nxënës, ndërsa në anën tjetër është 222 meshkuj dhe 84 femra është kalkulim jo i saktë, sepse nuk del kjo shifër 592. Ky është një fenomen tepër shqetësues, janë kryesisht të rinjë që ikin pa i mbushur 18 vjet. Kjo politikë dëshiron trajtim në nivel vendi jo vetëm në Komunën tonë.

Qështja tjetër që është shqetësuese është testi i Maturës në tri shkolla tona është numri në disporpocion të madh, Gjimnazi me 300 nxënës ndërsa këto dy shkolla të tjera njëra 60 dhe tjetra 61. Është më mirë me i orientu prindërit e nxënësve me i shpërnda dhe në këto dy shkolla të tjera.

E cekët që janë në fazën e fundit të realizimit të dy çerdhet në Malishevë dhe Kijevë dëshirova të di a ka më shumë aplikacione sesa kërkesa dhe a është bërë ndonjë ndarje të çerdheve a gravitojnë fshatrat të cilat janë në Kijevë.

Dua ta di dhe qështjen e konkursit të drejtorëve të shkollave i cili është anuluar për arsye që keni thënë nuk janë plotësu disa standarte dhe kriteret, kur pritet të rihapet ai konkurs, kur mundemi me ristartu me drejtorë të rinjë?

E kam parë konkursin e rregullt në arsim, që ka pasur shumë pak vende të lira të punës, a ka përfundu ai konkurs, a është përmbyll kjo fazë dhe a ka pasur ankesa?

Te faza e përgaditjes së sezonit të dimrit, unë i kam parë disa shkolla që nuk ju kanë funksionu kalldajat për arsye të energjis elektrike, dhe kryesisht kanë qenë të vogla krahasuar me objektin qfare kanë shërby ato.

A është bërë zëvendësimi i tyre qoftë prej peletit apo me naftë, nuk e di qfare janë ato sepse nuk jam i asaj fushe vetëm e di që kanë pasur probleme të mëdha.

Renovimi i shkollave, po flas për shkollën në Lladroc të cilat i patëm dy apo tri takime nuk është mirë në aspektin sanitar, është shumë problematike mirëmbajtja e tyre, përse po ndodh kjo gjë a është mos puna e stafit teknik apo qfarë është?

Përveq objektit të shkollës së vjetër në Banjë që ka fillu me u renovu dhe me u hap një çerdhe, a pritet me pas një objekt tjetër në Carrallukë, Drenoc, me bërë një qerdhe tjetër publike që me plotësu kërkesen me i dërgu fëmijët në qerdhe.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Drejtoreshë, faleminderit për raportin!

Unë nuk dua të merrem me detaje sepse nuk e kam materialin për disa qështje të cilat i ngritën parafolësit, kjo është përgjegjësia juaj sepse janë shumë gjëra të cilat varen nga niveli qëndror por ajo qka është e juaja është përgjegjësi.

Qështja e parë Drejtoreshë e kemi pasur debat disa herë këtu, është qështja e Drejtorëve të shkollave, për fat të keq që kemi probleme në këtë aspekt. Shumë shkolla janë pa Drejtor që sa vite, konkursi është anuluar dhe nuk është bërë asnjë njoftim publik për qfarë arsye, na është thënë në këtë foltore që nuk ka pasur konkurrencë, por njoftim zyrtar nuk keni bërë. Ky nuk është interes i imi por i shkollave, për arsye se aty ka mungesë të komunikimit të hartimit me ministri ku ka vite që ne ballafaqohemi. Në mandatin e parë ose të dytë të Nismës është qështja e kordinatorëve të cilësis, a kanë të gjitha shkollat në nivel të Komunës kordinator të cilësis dhe tregona se kush janë ata dhe cili është roli i tyre?

Për arsye se qështja e formave të shpeshta siç e dinë dhe ti Drejtoreshë, ka qenë që qështja e kordinatorëve me u pagu gjysmë norme edhe pse janë paguar asnjë punë nuk kanë kryer.

Sa shkolla janë në renovim?

A fillon objekti i ri në shkollën “Asim Vokshi” në Panorc meqenëse është i përfunduar?

A janë realizu pritjet e Drejtorisë për regjistrimin e nxënësve për arsimin e mesëm?

A është momenti i fundit me shku drejt profilizimit me hyrë në funksion për qfarë janë ndërtu, për arsye se tha dhe Vetoni shpërndarja nuk po bëhet në mënyrë të drejtë.

Nëse i shihni politikat e Ministris, raporti i shkollave profesionale me atë të Gjimnazit është 30-70, te ne ndodhë e kundërta për fat të keq.

Një problem tjetër sidomos shkolla jonë që e ka, pasi që Kompetenca menaxhohet prej MASHT-it, e kemi një problem shumë të madh në aspektin e realizimit të praktikës profesionale. Besoj që keni pasur takim me zyrtarë të MASHT-it, kam qenë dhe unë i ftuar dhe nuk kam mundur me marrë pjesë për arsye familjare. E ceke që jem shembull për Komunitat rreth nesh, unë i kam vizituar disa shkolla, janë të avancuara në aspektin e sigurimit të nxënësve të cilët janë duke përfunduar praktikën profesionale konkretisht në Suharek. Si rezultat i marrveshjes me kompanin biznesi kanë fillu edhe me u pagu disa prej nxënësve të cilët e përfundojnë praktikën. Kjo bëhet në mënyrë institucionale, memorandumet në mes të DKAS, bizneseve dhe shkollave, jo vetëm me i thënë nxënësit shko në praktik, mirëpo duhet me u institucionalizu kjo punë.

Kam punuar një projekt të firmave ushtrimore, besoj që dhe ti ke punuar në Kompetenc, kam thënë që ka qenë një ndër projektet më të qëlluara për Arsim profesional në momentin që e kanë lënë projektin Ebonenti Austria ne nuk jemi përkrahur dhe projekti po dështon. Në Ministri kem pasur takim sepse këto reformat e shpeshta neve po na krijojnë huti, sepse janë problematike. Në aspektin e kësaj a keni pasur takim ose a keni bërë diqka, a keni gjetur ndonjë modalitet të Komunave të tjera në këtë drejtim?

E di që është bërë zhurum atë ditë për shkollën “Lasgush Poradeci”, që u kërkua një drejtim me u ndërru statusi i shkollave me dalë në i afteve, nuk ka qenë qëllimi aty por unë kam kërkuar me u zbatu vendimi i institucionit për atë që është marrë. Duhet me u ndërru vula dhe duhet me u

ndërru dëftesat, është problem që duhet me u adresu dhe me u zgjidhë.

A do të fillojnë qerdhet me 1 shtator, a janë plotësu kapacitetet, a është bërë për 80 fëmijë? Një shqetësim tjetër shumë i madh të cilin e cekët është braktisja shumë e madhe e shkollave nga nxënësit sidomos shkollat e mesme. Kisha kërkuar përgjigje në këto qështje të cilat i ngrita, për arsye se gjatë komunikimit institucional shumë gjëra të cilat kanë fillu kanë mbetur në gjysmë, dhe ne po kemi problem të komunikimit kordinator të cilësis. Gjeni njerëz të cilët janë të gatshëm mos të dalin nga shkolla e tyre, të paktën në shkollë të tyre të japin kontributin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Faleminderit Drejtoreshë për raportin!

Sigurisht që dhe unë i bashkangjitem kolegëve për shqetësimin për libra të nivelit qëndror, është një shqetësim shumë i madh për të gjithë. Është përgjegjësi qëndrore në të njëjtën kohë dhe ne si Drejtori e Arsimit duhet të i bëjmë presionet tona në forma pozitive për arsye se bartim përgjegjësi. Nuk ka ndodhë asnjëherë në historin e Kosovës që 10 ditë para 1 shtatorit të bëhet një temë diskutimi librat, kjo është shqetësuese. Ajo çka kisha kërkuar nga ju si Drejtoreshë të furnizimet me mjete higjieno-teknike në mënyrë sanitare në shkolla pa i përjashtuar printerët, fotokopjet dhe gjërat përcjellëse që një shkollës i duhen, kjo është primare për ju, që të i pajiseni sepse ka shumë nevoja në shkolla për këto mjete.

Çerdhet shpresojmë të hapen me një shtator, duke i zgjeruar dhe në fshatra të mëdhaja tani e kemi buxhetin, kërko mjete vazhdo me hapjen e qerdheve, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta ndalojmë migrimin dhe i japim më shumë përparësi gjinis femrore të shkojnë në puna dhe të i lëjnë fëmijët në qerdhe. Këto janë disa shqetësime të cilat dëshirova me i cekë.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka asnjë tjetër për diskutim, ftoj Drejtoreshën që të i përgjigjet pyetjeve të cilat i bënë asambleistat.

Arbëresha Krasniqi: Faleminderit të gjithëve për kontributin të cilin e dhatë dhe për pyetjet të cilat i ngritët të cilat janë në interes të qytetarëve por në veqanti të punonjësve të arsimit dhe të nxënësve të cilët i kemi në shkolla. Qështja takimit në Ministri të arsimit, Nebihi e cekti që e kanë bërë lëmsh dhe ne ju kemi thënë që e keni bërë lëmsh, nuk po them që e kanë bërë keq se mundet mos me qenë keq por e kanë marrë një vendim në kohën kur nuk duhet të meret ai vendim, dhe vendimi që merret kur nuk duhet të merret bëhet më i rënd kur ka të bëjë me një kategori të madhe të njerëzve të cilët i adresohen kësaj qështje. 300.000 prindër, deri dje kemi informacioni e fundit 80.000 aplikime, është një numër shumë i madh i mundësive të gjykimit të asaj që duhet me fillu pa libra sepse nuk kanë mjete.

Shqetësimi tjetër të cilin e kemi është që sot e kemi mundësin përzgjedhëse e librave nga dega profesionale, që është shumë vonë. Ne kemi punuar në aktivat profesionale në shkolla, atyre i shkojnë katalogët për përzgjedhje të teksteve madje që gjithmonë është folur dhe i kam përkrahur dhe unë me ju ikë monopolëve që është quajtur monopol Dukagjini si shtëpi botuese, është quajtur si monopol Albas si shtëpi botuese dhe gjithmonë është diskutuar të ngriten këto shtëpi

botuese të cilat kanë qenë serioze në të kaluarën dhe vazhdojnë të jenë dhe sot. E them me përgjegjësi të plotë që nuk ka heqje të monopolëve, përkundrazi ka koncentrim të monopolëve, pra nga 20 shtëpi botuese janë të koncentruara, të përzgjedhura nga MASHT-i dhe akterët të cilët funksionojnë në dy shtëpi botuese Dukagjini dhe Albasi. Nuk dua të hyjë në hak të filtrave të cilat kalojnë këto libra por dyshimet e mia janë këto, nuk është qështja ime kjo, nuk është qështje e Komunës është qështje të cilën i prek të gjithë prindërit dhe të gjithë juve. Është shumë e dhimbshme sepse na kanë sjellë diqka tjetër, qështja tjetër duke ju ikur atyre krijimeve të monopoleve qfarë të bëjmë ne, nuk do ja dhëjmë parat atyre por do ja bëjmë kështu me ju kalu në gjirollogari të prindërve kjo është shqetësuese, unë po e gjykojë jo vetëm si Drejtoreshë e arsimit por si nënë e fëmijëve. Amrushë më ndihmojë sot me apliku në E-kosova me atë system të ndërlikuar që kanë ditë me bërë ata, llogarit se qfarë do të ndodhë me një pjesë dërmuese të prindërve të cilët e kanë shumë problematike.

Unë kam bërë reagim publik, kam bërë dhe në media, dhe në takim nuk jam kursyer, sepse kam menduar se duke bërë reagime, duke bërë kundërshtime të bazuara gjithë herë i ndihmojë procesit të arsimit. Është vetëm një problematik e cila është dalur në shesh, aty janë shumë problematika dhe jam e bindur që do të dalin të gjitha që janë duke e dëmtuar procesin e mësimi. Asnjëherë nuk ka qenë e përkryer qështja e arsimit në Kosovë, por jo në këtë mënyrë jo në fazën testuese. Është psikologjike dhe është shumë e rëndësishme me i pas fëmijët librat, jam e bindur që ky kaos ka me vazhdu kur te shkojnë me i marrë në Prizren, nuk do ta dinë se qfarë libra ka përzgjedhur mësuesi i cili ka përgadit plan-programin, a e ka zgjedh librin e gjuhës shqipe të Albasit apo Dukagjinit nuk e kanë as këtë qartësi. Mbesim me shpresim që do të fillohet dhe ndoshta do të kompenzohet kjo humbje që do ta kenë fëmijët me tekste shkollore. Problemi tjetër që është, 80% të librave të klasës VI dhe IX janë me libra të punës dhe fletore të punës të cilat janë të plotësuar, dhe normal që janë të plotësuar sepse atëherë janë kërkuar që të plotësohen, nëse nxënësi nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë në fletore pune ai është ndëshkuar qoftë me notë apo në forma tjera. Librat të cilat i kanë përdorur fëmijët e klasës së VI e të cilat do ti përdorin fëmijët tani të cilët do të dalin në klasë të VI janë plotësisht të papërdorura sepse nuk mundesh me i ru librat të cilat i përdor një vit të tërë. Ne do të ballafaqohemi me këtë situatë, shumë pak vendime mundemi me marrë ne nëse nuk kemi bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, ne nuk mundemi me bërë asgjë nëse ata nuk janë angazhuar në drejtim të udhëzimeve të cilat përpilohen të cilat preken të gjitha Komunitatet në Kosovë.

Labinot nuk e ceka Suharekën por në disa Komuna të cilat kanë buxhet më shumë, që kanë mundësi më shumë jemi konkurent por nuk ndihna komod, por ne jemi duke e bërë të pamundurën të mundur me kufizimin buxhetor që e kemi me qenë afër me i shërby shkollave tona për këtë mbaj përgjegjësi dhe them që nuk jam duke u kursyer për me ju ndihmu dhe me qenë afër shkollave. Vetëm e kam falenderu Ministrin dhe stafin mbështetës për mbështetje financiare për Komunën e Malishevës për qerdhen në fshatin Banjë. Pak Komuna kanë fituar sepse nuk kanë ditur të i plotësojnë kërkesat dhe kriteret të cilat kanë qenë të parapara në Ministri të arsimit. Është duke u punuar mirë dhe mendoj që ka me qenë ndër qerdhet model në Republikën e Kosovës.

Konfirmimi tjetër ka ardhur dhe për shkollën e vjetër në Dragobil dhe aty jemi në fazën e vlerësimit dhe ajo shkollë do të bëhet qerdhe shumë shpejt. Kur e kam bërë kërkesën për shkollën e vjetër në Banjë me kthi në qerdhe, kriteri i parë i cili ka qenë është numri i fëmijëve dhe numrin e fëmijëve e kemi marrë në zonën e caktuar Banjë, Kravasari, Temeqinë, Ngucat, pjesa andej. Njëkohësisht me të njëjtën degë kemi vazhduar për qerdhen në Dragobil pra gravitojnë afër 7 fshatra të cilat do të mbulohen me akomodimin e fëmijëve në qerdhe. Jam e sigurt që do ta fitojm dhe qerdhen e dytë të mbështetur nga Ministria e Arsimit.

Jemi duke punuar shumë me i hapë, është 10 ditëshi i fundit që intenzivisht që jemi duke u marrë 100% me qerdhe, e kemi këtu asambleistin që është dëshmitar i takimeve të cilat i kemi mbajtur të cilat kemi të bëjmë me operatorët të cilët kanë konkuruar dhe kanë dëshiruar me marrë inventarizimin në Kijevë. E kanë nënshkruar një kontrat ku ceket që mbrenda 20 ditëve duhet të inventarizohet qerdhja, kanë kaluar 3 muaj dhe biznesi nuk ka qenë i gatshëm me përmbyll së inventarizuari qerdhen në Kijevë. Ja kemi dhënë një afatë kohor nuk po dëshirojmë me hapë qerdhen në Malishevë pa e hapur qerdhen në Kijevë, sepse me një konkurs janë pranuar të gjitha. Burimin e kemi këtu e falenderojë për angazhimin të cilin e ka bërë, kemi qenë bashkë dhe kemi kërkuar në mënyr të preme që dita e fundit me qenë dita e diele, që unë ka me thirrë srafën teknik me shku me bërë pastrimin dhe më nuk ka me pasur punë me operatorin sepse ai do ta inventarizojë. Mbesim me shpresë që do të ndodhë kështu.

Nënat janë të gjitha gratë të cilat janë punësuar Nebih dhe për këtë jam krenare shumë dhe po ndihna mirë që të gjitha janë gra, janë të profesionalizume, mendoj që kanë me bërë një punë shumë të mirë. Edukatorët të cilat janë këtu janë duke bërë një punë shumë të mirë dhe e di që shumë prind të cilët i dërgojnë fëmijët aty kanë fjalë të mira për punën të cilën e bëjnë edukatorët dhe stafi menaxherial i qerdhes. Besoj që dhe këto qerdhet do ta ndjekin shembullin e kësaj qerdhe që e kemi në Malishevë.

Puna e konkursit të Drejtorëve, unë i kam dy mundësi të bashkëpunimit dhe ata të cilët janë drejtor duke qenë ushtrues detyre. Nuk kam ndonjë llojë dallimi në punë apo shërbim, ata të vendimit për 4 vite dhe ata të cilët janë ushtrues detyre. Ju kom ofru një mundësi me dëshmuar që nëse ata kanë kontrata munden me dhënë një kontribut më të madh për të na bindur dhe neve si institucion që me shpallë konkursin dhe me i bërë me kontrata. Kjo nuk do të thotë që mundet me na dal me hapë konkursin dhe Drejtorët me u shpallë si të rregullt dhe kjo do të ndodhë shumë shpejtë. Ne kemi realizuar një trajnim që ka të bëjë me udhëheqjen arsimore, aty është shfaqur interesimi që disa prej kandidatëve veq se e kanë pothuajse të përfunduar këtë trajnim. Unë besoj që në konkursin e ardhëshëm do të kemi njerëz potencial që do të aplikojnë dhe do të i marrin pozicionet e tyre në shkolla. Nuk ka qenë vetëm një vendim për anulim, por ka qenë i bazuar sepse nuk ka pasur konkurentë. Kordinator cilësie Labinot ka pasur dhe më herët, për arsye të ngarkesave buxhetore në Drejtorinë e Arsimit kam pasur raste që jam njoftuar personalisht nga ata që nuk janë paguar, dhe Kordinatori cilësie në disa raste është përdorur dhe për plotësim norme, por jo si kontributdhënës në kuptimin e cilësis. Jam duke bërë shumë përpjekje që mos me lënë fundin e orëve të parapame dhe në vijën buxhetore nga Ministria e Arsimit që ka bërë një punë shumë të mirë, që kordinatori i cilësis mos me qenë ai që i plotësohet

norma. Kordinator do të jetë ai i cili i ndihmon sistemit arsimor me punë dhe me profesionalizëm.

Shkolla "Asim Vokshi" mbetet problem në vete, unë ende shpresoj që do të fillojmë mësimin në shkollën e re, përpjekjet i kemi bërë unë dhe Kryetari i Komunës. Inventarizmin e kemi bërë të gjitha kushtet janë plotësuar që të vazhdohet mësimi në shkollën e re.

Statistikat të cilat i ceki Vetoni, janë shqetësuese numri i lëvizshmëris, ne ende nuk i kemi të finalizum përfundimisht rezultatin për arsye se i kemi pasur në riprovim nxënësit e tjerë dhe nuk e kemi të saktë një shifër. Kjo shifër të cilën e keni para vetës është shumë e lartë dhe frikohna që një pjesë e rinis tonë do të shkojë fatkeqësisht, po ndodhë dhe me stafin mësimdhënës dhe nuk ka dhe shumë të drejtë ligjore ajo që do e them por dua ta ceki para jush me mirëkuptimin e plotë, shumë mësimdhënës kanë kërkuar pushim 6 muajsh dhe shumë prej tyre 12 muaj për të shkuar me jetu në shtete të Evropës. Kur kanë ardhur me bisedu me mua ata i kanë pasur dy mendime në kokën e tyre si me jetu në Kosovë me këtë gjendje ekonomike, dhe e dyta merrne me mend ju bie me shku njerëzve në Gjermani që ndoshta nuk kanë dalur asnjëher nga Kosova dhe hiq nuk e dinë se qfarë ndodhë atje. Atyre të cilëve ju kemi mundësuar 6 mujorin me shku në vende të tjera ka qenë ky sepse ai dhe ashtu është pa kontrat kështu që ata të cilët rikthehen në Kosovë unë kam me bërë të pamundur me i rikthy në vendin e punës.

Nxemjet Veton, përjashtoj Kijevën shkollën fillore që duhet të bëjmë një investim të një rezervari, kemi probleme aty. Besoj që të tjerat furnizimin me kalldaj i kemi bërë në mënyr masive në vitin e kaluar. Nuk kam asnjë frik që do të hyjmë në sezonën e dimrit dhe ndonjë nga shkollat do të jetë pa nxemje.

Investimet të cilat i kemi bërë në efqencë janë investimet më të mira të mundshme, është një vlerë e madhe që kalon shifrën mbi dy milion euro.

Qështjet e higjienës, ne kemi pasur kontratë 80% të Drejtorëve kur i kam në takim thojnë që është mirë mos me sjellë paisje të higjienës dhe dy tre muaj sepse kemi shumë. Kur shkojmë me i vizituar shkollat nuk e kemi pastërtin të cilën e dëshirojmë, problem tjetër që ne jemi duke u ballafaquar është nyje sanitare të cilat si projekte ndahen pra të furnizuarit me paisje higjienike është diqka tjetër dhe të furnizuarit me nyje sanitare është diqka tjetër. Nyjet sanitare kemi bërë kërkes, përveq kësaj i kemi bërë kërkes më ndryshe se herave të tjera duke menduar që ka me na shërby më shumë jo vetëm furnizim por do ta përfundojnë dhe punën kompania e cila e fiton tenderin për furnizim. Ju kërkoj të gjithëve bashkëpunim dhe ju falenderojë të gjithëve për pyetjet të cilat i ngritët.

Argjend Thaçi: Të falenderojë Drejtoreshë për prezantimin e këtij raporti. Mbyllim këtë pikë të rendit të ditës, për të vazhduar me pikën e radhës e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.

Urdhëro, Drejtori Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Në seancën e kaluar është shty ky raport kjo ka ndodhur për herë të parë që nga viti 2009 që jam pjesë e këtij kuvendi. Gjithmonë raportet e auditimit janë raportuar nga Drejtoria

e financave, ana ligjore e prezantimit është nga ana e Kryetarit por e autorizon një këshilltarë të vetin një zyrtar, për të cilin është marrë kordinatori i auditimit që është zyrtar i financave, gjithmonë është prezantuar nga Drejtoria e financave por sido që të jetë është prap vendim i juaji. Një kërkes ka qenë që me ardhë auditori i mbrendshëm, por një auditor i mbrendshëm nuk ka të bëjë me auditorin e jashtëm.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Drejtor, ë në këtë raport të auditimit kemi dëshirë ta kemi Kryetarin këtu, sepse është njëra nga pikat më të rëndësishme të Komunës dhe duhet me qenë Kryetari prezent, por nëse ti e ki një autorizim nga Kryetari ne mundemi me vazhdu nëse je i gatshëm me ju përgjigj pyetjeve dhe sqarimeve që ne do të i ngrisim. Ne për këtë arsye e kemi shtyer dhe në seancën e kaluar që me qenë Kryetari për ta prezantuar këtë raport, jo me ardhë auditori i brendshëm nuk e di nga e ke marrë këtë informacion. Unë me kënaqësi kisha pasur dëshirë me pas Kryetarin me u ballafaqu me atë, por sido që të vendos kuvendi unë do ta marrë fjalën për pjesën e auditimit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ligjërisht për raportin e auditimit, por dhe për secilin raport për qdo drejtori është i obliguar Kryetari me dhënë llogari. Mirëpo meqë Kryetari i delegon drejtorat të drejtorive përkatëse të raportojnë raportet e tyre para nesh dhe në këtë rast siq raporton Drejtori i financave për Drejtorin e financave në emër të Kryetari, për ne nuk është problem që Drejtori i financave ta raporton dhe këtë raport të auditimit si i deleguar i Kryetarit. Kështu që nëse Drejtori është i gatshëm për ne mund ta laburoj para nesh dhe ta diskutojmë.

Argjend Thaçi: Pasi që e keni materialin para jush mund të filloni të diskutoni dhe të i bëni pyetje Drejtorit dhe ky të ju përgjigjet.

Rukije Bytyqi: Materiali ka mungesa të faqeve nuk është ardhur komplet.

Argjend Thaçi: Mund të ketë ndodhur ndonjë gabim teknik. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në material po shihet që mungon nga një faqe dhe që është problem me nxjerrë një qëndrim për këtë raport të auditimit. Kështu që nëse nuk kish pasur problem me shty për atë seancën e jashtëzakonshme. Por nëse na laburon Drejtori këto faqe të cilat mungojnë mundemi me vazhdu për ne jemi për cilëndo alternativ që zgjedhet.

Argjend Thaçi: Neve në Kuvend na është ardhur fizik kështu siq është me këtë gabim. Urdhëro, Drejtori Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Unë për këtë arsye jam duke ardhur për prezantim të raportit dy herë, ju kryesisht do të flisni për të gjeturat e auditorit, nëse nuk e keni në raport i keni te plani i veprimit që për herë të parë do të jetë në shqyrtim plani i veprimit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Kjo mundet me na kushtu dhe te raporti i performancës në qoftëse nuk e trajtojmë dhe e shtyjme këtë raport. Këto faqe të cilat nuk janë fokusohet në elaburim Drejtori, në mënyr që mos ta shtyjme dhe mos të humbim pikë në performancë për një qështje të cilën ne mundemi me kërkim informacion shtesë për këto faqe të cilat nuk i kemi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Nëse humb performanca, e humb ekzekutivi për arsye se prej 8 rekomandimeve të cilat i ka bërë zyra e auditorit 5 janë të përsëritura vetëm 3 janë të reja. Nuk do të thotë që këta e humbin performancën, ne duam ta kemi Kryetarin përball dhe të diskutojmë për këtë pikë. Unë jam për me shty këto pikë, dhe hudhe në votim propozimin tim.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim propozimin e Nebihit. Kush është për që Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022, të shtyhet për seancën tjetër?

Për: 8

Kundër: 13

Abstenim: 0

Me 8 vota për, 13 kundër, asnjë abstenim kjo pikë mbetet si pikë e rendit të ditës. Urdhëro, Drejtor për prezantim të këtij raporti!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare për vitin 2022, me theks të veçantë procesohet që është me një rezultat që është i pa kualifikuar dhe vlera është me rëndësi të veçantë sepse na dhuron një anë pozitive të qështja e prezantimit të performancës si Komunë. Është e vërtetë ajo që e cekim Nebih që në raport kemi 6 rekomandime, 3 janë të reja dhe 5 janë të përsëritura. Ndërsa nga raporti i mëhershëm kanë qenë 11 rekomandime 6 prej të cilave janë plotësuar, dhe 5 janë të përsëritura, 3 janë të reja. Këto 3 të reja janë të sektori i prokurorisë ku është kërkuar qështja e kriterëve dhe plotësimin e fondacionit në shpalljen e tenderëve. Të rekomandimet e tjera në pjesën e atyre të cilave janë përsëritur e cekim qështjen e disa faturave që kanë përfunduar apo nuk janë përfunduar brenda afateve ligjore do ta dhë arsyen përse kanë ndodhë. Njëra prej tyre të cilat i cekim që janë të reja vendosja e tenderëve nuk ju është bashkangjitur projekteve ekzekutive si pjesë e specifikave teknike, gjë që duhet të prezantohet nga Prokuroria. E cekim vonesën e pagesave për fatura mbrenda afateve ligjore, këto janë 5 fatura të cilat janë gjetur nga Auditorët, të pasurit kapitale dhe jo kapitale të cilat janë të prezantuara PFV, këtu është mbi vlersuar sipasoj e mos zhvillimit të disa rasteve pra qështja e regjistrimit të E-pasuris. Ne e dimë rastin aty kemi pasur përmisime, por kemi të bëjmë me një zyrtar të pasuris ku është ende i pa plotësuar me pjesën tjetër të zyrtarit për E-pasuri. Rekomandimi i tjetër është si emërtim klasifikimi mirëpo është e mirë sepse asnjë shpenzim nga ana e ekzekutivit nuk është jashtë kategorive siq ka ndodhë në disa Komuna të tjera, të ne kanë qenë mbrenda kategorive por duke shtuar dhe dëmtimin e asambles për zbatimin e ekzekutimit të mjeteve për projekte kapitale të cilat ju keni qenë pjesë e atij aprovimi. Këto janë ato pikat për të cilat janë kërkuar rekomandimet e auditorit,

të cilat i kemi paraqitur në planin e veprimit zbatimin e rekomandimeve që ne të i përmisojmë dhe të i rregullojmë të gjitha këto.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Në Raportin e Auditimit paraqiten vetëm gjetjet apo rekomandimet të cilat janë plotësu, apo janë në proces apo nuk kanë filluar fare me u plotësu në bazë të mostrave të cilët ata i marrin si rast për auditim. Ajo që e shikova te disa rekomandime për të cilat nuk është filluar ende zbatimi i tyre e që kisha kërkuar mi marrë hapat e nevojshëm me i rregullu këto është te pasurit. Në kohën 2020-2021 në pandemi kemi pasur problem për arsye se nuk kemi pasur zyrtarë të pasuris, për arsye se zyrtari që ka qenë aty, ka qenë me probleme shëndetësore dhe në bazë të rekomandimeve të ministris së shëndetësis është dashur me liru atë nga puna. Besoj që tani jan kushtet Drejtor, nëse nuk ka ende zyrtar të pasuris, duhet me i iniciu procedurat për zyrtarë të pasuris, dhe me fillu me i regjistru pasurit Komunale.

E lexova më lartë te B1, disa lloje të pasurive nuk janë regjistruar si duhet dhe si rezultat kanë ndiku në mbivlersimin e pasuris, ky mbivlersim ka ardhë si pasoj e mos regjistrimit adekuat, dhe si rezultat nuk ka mundur me u zbrit zhvlersimi i periudhës dhe zhvlersimi i akumuluar në bazë ligjit siq është e rregulluar.

Pika tjetër që do të duhej me iniciu procedura për me i mbledh këto borgje është pika e 9, përkatësisht llogarit e arketueshme është një rekomandim i cili nuk ka fillu me u zbatu. Unë e di që na kanë shumë borgj neve si Komunë, kryesisht nga tatimi në pronë dhe nga taksat për ushtrimin e veprimtaris që janë larguar bizneset. Për te tatimi në pronë afër 2.000.000.00E janë obligim që i kanë Komunës dhe afër 1.000.000.00 euro janë te taksat të ushtrimit të veprimtaris. Te tatimi në pronë është e rregulluar me ligj që nuk mundesh me kërku borgjin e periudhave shumë të përparshme, për te taksat e ushtrimit të veprimtaris është situatë tjetër, ku ndoshta është mirë me u konsultu me ligjin për marrëdhëniet dhe detyrimet ku është i paraqitur që deri në tri vite ki të drejtë me kërkuar borgjin dhe më shumë jo.

Unë kisha kërkuar që nëqoftëse ju konsideroni që është më e lehtë me ngrit një Komision punues i cili do të mirret me identifikimin e këtyre rasteve te taksat e bizneseve dhe me i shiku se cilat prej atyre duhet me i shly prej asaj liste dhe me i paraqit si borgje të pa arkëtueshme, në mënyrë që me i pastru dhe listat e këtyre obligimeve të cilat i kanë Komunës, në mënyrë që përformanca dhe raporti i auditimit me dalë herave të tjera më i kompletuar, dhe pa këtë rekomandim.

Pika e 3 është obligimet e pa paguara meqenëse e ka shënu auditori që nuk ka filluar zbatimi por unë e di që realisht fillon zbatimi, qdo herë ka pagesa.

Te obligimet është pak e komplikuar situata, sepse ka shumë faktor që ndikojnë, përshembull nëse e kemi pasur një rrugë në kontrat të vitit 2021 një pjesë të punës e ka përfunduar, një pjesë të punës nuk e ka përfunduar e ka faturu ka kaluar viti fiskal, i njëjti kod nuk është përcjell në periudhat pastruese, dhe normal që kjo e shkakton opinionin apo rekomandimin si vonesa për ekzekutimin e pagesave. Raporti është i pa modifikuar dhe nuk ka material për këtë qështje e cila i hap rrugë Komunës të aplikoj dhe mund të jetë përfituese potenciale e granteve të përformancës të cilat i dhuron Qeveria përkatësisht Ministria dhe organizatat e tjera të huaja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Faleminderit Drejtor për elaburimin e raportit!

Tani e pash që mungojnë disa pjesë të raportit, ndoshta kemi arsye shtesë për ta shtyr për seancën e jashtëzakonshme, por meqë nuk ndodhi po mundohna të i ngris disa qështje në këto faqe të cilat i kam përpara. Një vërejtje që e keni marrë nga Auditori është mungesa e regjistrimit të pasuris në sistemin e pasuris, në raportin e kaluar ka qenë si arsyetim i qeverisjes nuk kemi pasur zyrtar përgjegjës të pasuris me përfunduar këtë punë. Mendoj që dashur të përfundoj kjo që mos ta kemi si vërejtje të përsëritur në këtë raport.

Një qështje tjetër shumë e rëndësishme vonesa në përfundimin e pagesave mbrenda afatit 30 ditë, këtu auditori ka gjetur vërejtje që këto pagesa kanë përfunduar në 5 fatura të ndryshme nga 171 ditë deri në 327 ditë, pra ka pasur vonesa më shumë sesa lejon afati ligjor. Përse po ndodhin këto vonesa, kur është e parapamë faza ligjore?

Qështja tjetër është mos publikimi i kontratave të nënshkruara në databazën e prokurorit, është një shqetësim i duhur që e kanë ngrit Auditori, është mirë që secila kontratë të publikohet.

Rekomandimet e përsëritura nuk e di qfarë po pret qeverisja Komunale që nuk i zbaton vërejtjet të cilat na jep që mos të përsëriten në vitin tjetër. Neve po na kushton në performancë dhe Grandin e performancës, nuk po mundemi me përfitu projekte të ndryshme, për arsye të disa qështjeve të cilat janë lehtë të përmisueshme. Unë pres që të paktën këto 5 rekomandime mos me ardhë të ripërsëritura dhe herën tjetër të përmisohen këto.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Të gjithë ata të cilët e dinë se si funksionojnë institucionet publike e dimë që nuk ka raport të auditimit që vjenë pa vërejtje, pa të gjetura apo rekomandime, sepse institucionet gjithmonë kanë nevojë për përmisim dhe ky përmisim kurr nuk ka një kulëm që mundemi e thënë tani e kemi arritur kulmin.

Shumica e diskutimit u bërë të sasia se sa rekomandime i kemi, shumë më e rëndësishme është qka kanë mbrenda këto rekomandime të qfarë natyre janë, qfarë cilësie janë. Ngajëherë është mirë me qenë vetëm një rekomandim dhe me qenë më i rënd se 10 rekomandime të tjera. Në përgjithësi raporti nuk na është ardhur i kualifikum, në përgjithësi ky raport e cekë që pagesat janë përfunduar sipas standarteve të përcaktuara, pra na tregon që në përgjithësi ekzekutivi është duke e bërë punën e vetë siq duhet.

Disa rekomandime të cilat janë përsërit, do të përsëriten disa herë sepse nuk mundën me u realizu. Vonesa e pagesave nganjëherë bëhet për arsye të vonesave të fondeve që i lëshon qeveria. Për ato që është e mundur me i rregullu, për shembull publikimet me vones apo mos publikimi në ueb-faqe i qështjeve të prokurorit kjo është një punë që rregullohet dhe nuk mundet me u përsërit më. Unë kërkoj nga ekzekutivi sa më shumë që është e mundur këto rekomandime të cilat na i ka dhënë auditori i përgjithshëm me u mundu me u zbatu, aq sa ne kemi mundësi dhe kapacitet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati: Meqenëse u cekë nga Drejtori që plani i veprimit lidhet me pikën të cilën jemi duke e diskutuar, është një raport më i përmbledhur rreth vërejtjeve. Qështja e parë mungesa e autoritetit ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike, pjesa dytë mangësia e regjistrimit dhe vlersimit të pasuris, ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara duke i përfshirë në projekte të tjera më shumë i konsideroj gabime teknike apo procedurale. Te qështja B3 vonesë në pagesën e fakturave të pranuar. Në gjetjen që e ka bërë auditori është vonesa e fakturave për shërbimet e ofruara nga operatorët ekonomik të kontraktuar ose pagesat e tjera që rrjedhin nga detyrimet e komunës. Unë mendoj që vonesat janë shumë të dëmshme dhe këtu afati i pagesës sipas Ligjit është 30 ditë. Është shqetësuese vonesa mbi 30 ditë. 30 ditë janë të mjaftueshme nëse i përfillë procedurat nga fillimi. Defekti është shumë dimensional ligjore, ekonomike dhe sociale. Me operatorët ekonomik të cilët e kanë pasur një kontrat për të na furnizuar neve si komunë me shërbime ose me mallra ata janë hyrë në detyrime për të na furnizuar me mallra për ta mbuluar koston e prodhimit apo për ti mbuluar shpenzimet operative për realizimin e asaj kontrate. Në qoftëse komuna nuk e bënë pagesën me kohë atëherë e vendos në probleme financiare operatorin ekonomik. Shpeshherë bizneset që kanë kontrat për me kry punën, detyrohen që t'i vonojnë pagat e punëtorëve të kompanis, detyrohen të futen në borgje në banka komerciale dhe paguajnë kamat gjë që ndikon në rritjen e koston së punës për atë shërbim. Po ashtu në aspektin financiar bizneset janë të obliguara t'i paguajnë tatimet me prezantimin e faturës. Këto telashe mundën me vendos jo serioze kompanin.

Te pika e tetë- dobësit e menaxhimit të llogarive të arktueshme dhe këtu është vërejtja te drejtoria për buxhet e financa si dhe në sektorë të tjerë që kanë dështuar në mbledhjen e procedurave për me inkasuar kërkesat e veta, si për tatime në pronë, taksa komunale që i paguajnë bizneset, ne duhet me shtjerr mundësitë ligjore. Në qoftëse ne jemi tolerant ndaj mospaguesve të detyrimeve e bëjmë një padrejtësi ndaj atyre që janë pagues të rregullt të detyrimeve. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: E mira është që opinionin nuk ka me qenë pengesë që ne me qenë përfitues të granteve, në rast se kriteret e tjera janë të zbatueshme. Ajo te pagesa e faturave afati i rregullt është 30 ditë, dhe nëse operatori brenda 30 ditëve nuk i merr parat ka të drejtë mbas 30 dite me dërgu te thesari i përgjithshëm i Kosovës, nëse nuk i merr prapë mundet me dërgu te përmbaruesi. Të gjitha këto procedurat e paduhura se si rrjedhi është një situatë ndryshe Profesor i nderuar. Ka operator ekonomik që ka pasur në buxhet të vitit 2022 po e marrë shembull me përfunduar një kontrat të caktuar e cila është bërë e pa përgjegjshme sepse nuk e ka përfunduar punën dhe i kanë mbetur parat pa i marrë, mjetet kanë mundur me shku në suficid por i kemi destinuar në një projekt tjetër. Tani ai në vitin 2023 ka filluar me punë dhe i ka kërkuar mjetet, normal që nuk i paguhet ndoshta deri në vitin tjetër për arsye se nuk është më ai projekt në buxhet. Kjo është qështja e vonesave të faturave, është një qështje tjetër që ka pasur vonesa dhe mund të ketë vonesa te pagesa e faturave të mbeturinave për arsye se kategoria e shpenzimeve të

mbeturinave ka qenë 200,000.00E për të gjitha nevojat si shpenzime komunale, ndërsa vetëm një kontrat për mbeturina ka qenë më shumë se 200,000.00E vjetore dhe nuk ke pasur mundësi me pagu. Të gjitha këto punë shkaktojnë probleme, ajo që do të duhej me u marrë seriozisht është te llogarit e arkëtueshme sepse ato e zvogëlojnë performancën e Komunës më shumë se sa këto fatura se a paguhen mbrenda 30 dite apo jo. Kur vjetërsohet borgji të cilin ti nuk e ke kërkuar në vazhdimsi që ta paguajn borgjin, ai parashkruhet dhe është ligji të cilin e parasheh në qfarë periudha mund të parashkruhet.

Si ka ardhur deri te ky akumulim i këti borgji?

Ka qenë një periudhë ku njerëzit kanë hapur biznese vetëm thjeshtë sa me marrë një vizë për të dalur jashtë vendit dhe ati i ka mbetur emër si biznes, nuk është ardhur formalisht me shu biznesin por i ka mbetur aktiv dhe sa herë është procesu rregullorja ati ju është ngarkuar taks. Është mirë me pas një Komision nëse e konsideron qeveria që është e pa mjaftueshme burimet e tyre me i identifiku të gjitha këto raste, me i shly këto taksa. 3 vitet e fundit merrja parat të tjerat falja, e di që i diskriminon të tjerët të cilët kanë qenë të rregullt në pagesa, por ti nuk mundesh vetëm për këtë arsye me dalë gjithmonë keq ose me të mbet në llogari të arkëtueshme. Duhet me fillu me rregullu diqka.

Sa i përket obligimeve të tatimeve në pronë më herët kanë fillu me i dërgu në përmbarues ata të cilët kanë obligime të tatimeve. Mirëpo këto janë pare të cilat nuk parashkruhen, për arsye se shumë shpesh të ka shkuar njoftimi ke pasur afate që ta lehtësojnë me mujt me inkasu borgje në periudha të më vonshme.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka askush tjetër për debat, konstatoj që të pranishëm jemi 16 anëtarë që do të thot kemi kourum për vazhdim të punimeve.

Urdhëro Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Raporti është i pakualifikuar mbi bazen e disa kriterëve të cilat i ka pasur Auditori. Do të thotë që ne kemi një performanc pozitive dhe ne mund të jemi përfitues i grantit për vitin e ardhshëm mbi bazen e raportit. Raporti i auditorit për vitin 2021, është kualifiku pikërisht për kriterin e zyrtarit të pasuris, kemi pasur probleme me vendimin e qeveris që ka kërkuar për lehonat me qëndru në shtëpi dhe nuk kan mundur me hy në sistem të dhënat. Ajo pozit është plotësu nga Komuna dhe një zyrtar nuk mundet mbrenda një viti me i fut në sistem mbi 2000 lënd me i regjistru, një pjesë të madhe e ka regjistru dhe për këtë kemi marrë notë pozitive nga auditori dhe është në proces. Zyrtari i pasuris është në procedur të plotësimit të vendit, kemi dhe tre zyrtarë si zyrtarë të hyrave të pranimi të mallit, Komisioni prej tre anëtarëve nga Shëndetësia, Arsimi dhe Administrata që do të marrin shenime dhe do t'i evidentojnë në E-pasuri.

Te qështja e mbivlerësimit ju e dini që dhe regjistrimi i pronave inekzistente të cilat nuk janë shkollat të cilat i kanë shembur të vjetrat ende janë si kapital i Komunës dhe duhet të i bëhet mbizhvlerësim, të largohet si pasuri e Komunës sepse nuk ekziston.

Te qështja e mjeteve të arkëtueshme vitin e kaluar dhe në këtë vit është rrit inkasimi i të hyrave të Komunës, me ligjin e ri për tatimin në pronë është e evidentuar që borgjet e tatimit në pronë

parashkruhen për 10 vite e tutje.

Qështja për taksa është angazhuar dhe inspektoriati për qështjen e bizneseve të cilat nuk janë aktive dhe kam kërkuar që të lirohemi ndaj ai obligim mirëpo nuk ka kaluar këtu.

Te vonesa e pagesave një gjë ta keni parasysh që alokimi për buxhetin 2022 i Komunës tonë është bërë në maj, periudha e punës që ka përfunduar nga operatorët të cilët kanë pasur kontrata 2 vjeqare ai ka mundur me përfundim në mars dhe me u faturu. Prej vitit të kaluar dhe këtë vit e tutje shkon dhe planifikimi i shpenzimit është qështje faji i operatorëve, sepse këtë vit nëse një operator ka pasur planifikimin e shpenzimit me i marrë mjetet deri në mars dhe ai e ka sjellë faturën në prill nuk ke mundur me ekzekutu deri në Korrik, sepse lëvizjen e mjeteve nga thesari prej qeveris është e kushtëzuar në tre mujorsh. Vitin e ardhshëm nëse një operator ka planifikuar ta përfundoj punën dhe të i merr mjetet në maj, nëse nuk e ka përfundura punën në maj ai nuk mundet me i marrë mjetet deri në dhjetor. Kërkesa e pagesave nga kodet ekonomike brenda kategoris ka ndodhë por ne e kemi bërë dhe me kërkes të juaj dhe ju kam falenderu që kemi bërë pagesa të tilla që të mos shkojnë në suficid dhe të realizohen projektet të cilat janë duke u punuar.

Te pjesa e prokurorimit është qështje teknike mirëpo ka pasur probleme dhe Prokurorimi me disa gjëra të cilat nuk kanë qenë projektete e gatshme nga Urbanizmi që të i publikojnë. Ne e kemi dërguar sugjerimin nga Kryetari te Prokurorimi që të publikohen të gjitha këto dhe besoj që këto tri pjesë janë lehtë të zbatohen.

Argjend Thaçi: E mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës, për të vazhduar me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandieve, sipas rekomandimit të zyrës Kombëtare të Republikës së Kosovës për të gjeturat e vitit 2022. Konstatoj që 17 anëtarë jemi prezent kemi kourum. Urdhëro Drejtor Blirim Thaçi!

Blerim Thaçi: Është hera e parë që është kërkuar të vijë dhe plani i veprimit për qështjen e zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i jashtëm në Kuvend, ne atyre ju kemi dërguar por është kërkuar të vijë dhe në kuvend. Te plani i veprimit të gjitha rekomandimet të cilat janë cekë nga Auditori ne i kemi paraqit mënyrën e zbatimit të detyrës për vitin e ardhshëm, janë të gjitha shtyllat të cilat paraqiten se si do të zbatohet plani i veprimit.

Argjend Thaçi: Faleminderit Drejtor. Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Meqë ne i trajtëm këto dhe i cekëm këto rekomandime të cilat i ka dhënë auditori se si me u rregullu që mos të përsëriten më, e kam një pyetje Drejtor në këtë planin e veprimit të cilin e ke bërë sa prej këtyre rekomandimeve pret që vitin e ardhshëm mos me u përsërit më?

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor!

Blerim Thaçi: Te qështja e pjesës rekomandimet, te prokurorimi besoj që do të jetë i zbatueshëm nuk është që varet Drejtoria e Financave. Unë do kisha thënë cila do të jetë më problem me u zbatu, ku njëra prej tyre do të jetë qështja e vonesave të pagesave për arsye të planifikimit të shpenzimit kjo do të jetë pakë vështirë.

Qështja nga kodet ekonomike brenda kategoris ndoshta ndonjë rast do të jetë e pamundur implementimi, të tjerat do të jenë të zbatueshme.

Valon Mazreku: Te pagesa e fakturave, te plani i shpenzimeve këtu luan rol dhe plani i prokurorimit kryesisht te mallrat dhe shërbimet. Furnizimet rrallë janë dy vjeqare kryesisht janë një vjeqare, varësisht planit të Prokurorimit ne duhet të bëjmë dhe planifikimin e shpenzimit nëse ai ta ka sjellë planin e prokurorimit që ka me i marrë në mars, duhet të përfundoj ajo procedurë. Për me përfundu furnizimi në prill ti i buxheton ato në shkurt kjo tregon qrregullim, pra një vonesë e prokurorimit të largon prej sistemit. Te kontrata e punës është më lehtë me i menaxhu, sepse e bënë planifikimin qdo tre muaj dhe ndryshimet e pushtetit kur bëhen për Komuna, kjo i imponon që qeverit nëse nuk e vazhdon dhe vjenë tjetra nuk guxon me ndërru asnjë projekt, për veq kontratave të cilat i ka apo zotimeve tre vjeqare.

Blerim Thaçi: Këtë vit është më rigoroz, ne i kemi bërë pyetje ministris së financave, siq e ceke dhe ti një Kryetar ka buxhetu për tri vite ndoshta dhe vitin e fundit qfarë ndodhë nëse nuk kalon në asamble Komunale. Detyrimisht do të kalojnë në obligime, nëse nuk kalojnë kalon niveli i monitorimit prej nivelit qëndror dhe përfundohet ajo pjesë. Pikërisht vitit 2022 kemi pasur alokim të mjeteve në maj që atëherë ne e kemi bërë planifikimin e shpenzimit, por fatbardhësisht për vitin 2023 shkojë me kohë buxheti planifikimi i shpenzimit është bërë më mirë, dhe tani jemi në realizim të shpenzimit të kapitaleve 100% në shtator. Te pjesa e ministris që e ceka kam bërë diskutim me Ministrin e financave kur e kërkuam me u fal borgji deri 100 euro, tani ju po kërkon bugjetim, viti 2024 po kërkon me falë borgjin si i mbuloj kontratat tri vjeqare të cilat i kam të vitit 2021 në 2024. Drejtori i bugjetit thotë është dashur me i planifiku mbi bazen e bugjetit, unë tani po planifikojë mbi bazën e bugjetit por ti po ma cenon të drejtën, po ma ul buxhetin për të cilin kam planifikuar realizimin e këtyre projekteve.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka për diskutim më për këtë pikë të rendit të ditës, e mbyllim debatin. Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/287, e parashtruar nga Shkelzen Kryeziu.

Në fakt kemi tri kërkesa pothuajse të natyrës së njëjt për djegie, kërkesa e Shkëlzenit është djegia e shtëpis ndërsa këto dy shtëpit e tjera janë diegia e shtallës dhe ushqimit të bagëtis. Së pari vazhdojmë me kërkesën e parë nr. 01/287 e cila ka të bëjë me djegie të shtëpis ka kërkuar ndihmë me mjete financiare për renovimin e shtëpis, për arsye të kushteve dhe të pamundësis për të bërë renovimin vetë. Drejtor kërkojmë një opinion të juajin se sa mundemi me ja nda. Për këtë seanc për ndihma momentale për shërim nuk kemi sjellë, për arsye mos të ngarkojmë shumë buxhetin. Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Një takim të cilin e pata me Drejtorin e Bujqësis në ora 09:30, ka ardhë me një kërkes dhe kërkesa është shumë e arsyeshme sepse vendimi është i juaji, subvencionimi i qumshtit me 0.03cent dhe tani planifikimi ka qenë më i ulët dhe kostoja e realizimit të grumbullimit të qumshtit ka dalë më shumë se planifikimi për shpenzim. Po kërkon me ju mbulu ato mjete, pastaj e ceki dhe qështjen e subvencionimit për dhi dhe dhenë është një gjë që

numerikisht nuk e dimë sa janë. Dhe këto janë natyra që duhet të subvencionohen nga bujqësia sepse ishin për shtalla. Nuk kemi shumë mjete subvencionimi, ju mundeni me nxerr vendim por unë hallin e kam së pari me i siguru subvencionet për tejkalimin e grumbullimit të qumshtit. Nëse munden me u shty këto kërkesa për seancën tjetër unë ja u sjelli saktë të dhënat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Sa i përket shtëpis ne mund të ndajm mjete dhe sigurisht ti me i gjet por te pjesa e subvencionimit të shtallës të bujqësis mundet me lënë për ndonjë seancë tjetër. Por shtëpia nuk pret duhet me ja nda dakordohemi të gjithë me një shumë, nuk kemi nevojë me bërë politik.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Qe sa kohë ne kemi subvencionu raste të sëmundjeve të rënda dhe nuk kemi mundur të gjitha me i mbulu, nuk ka diskutim që është humbje për atë që ju ka djeg shtëpia vullneti i gjithësecilit këtu mundemi të ja ndërtojmë dhe më të mirë që e ka pasë. Përveq atyre sëmundjeve tani kan fillu me ardhë dhe natyra të ndryshme të kërkesave dhe e kemi të pamundur, unë nuk kam mundur me i analizu këto kërkesa dhe nëse është urgjente e shtëpis ne mundemi me i ndihmu sot kësaj kërkesë, ndërsa të tjerat të i shtyjme për ndonjë seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Nuk mundesh me pytë Drejtorin e financave se sa para kemi me ja nda, sepse në momentin që cekë vlera është paragjykim dhe të gjithë ne duhet me u sjellë rreth paragjykimit tënd. Njëra prej kërkesave të cilat ka ardhë dhe thotë ju është djegur kashta dhe shtalla si pasojë e mjeteve piroteknike, ata e kanë djegur vet dhe tani na me ja pagu kashtën dhe shtallën, për mua kjo nuk ka logjikë. Është e pa tolerueshme se si ka kaluar në KPF kjo kërkes kur kemi njerëz që janë të sëmurë, dhe kanë njëmijë nevoja dhe nuk po kalojnë këndeje ndërsa na duhet me ja pagu kashtën këtij që ju ka djegur nga mjetet piroteknike.

Njëra prej kërkesave të tjera ishte që ju ka djegur nga rryma, padite KEDS-in, nuk është Komuna shoqat humanitare që mundet me i ndihmu kujt i kallet shtëpia apo shtalla. Shtëpia është më e ndjeshme sepse nuk kanë ku me qëndru fëmija, kushtet ekonomike të dobëta dhe ja bëjmë disi i ndajmë këto mjete, por që ju është djegur shtalla nga mjetet piroteknike me i nda mjete Komuna, nuk është normale. Unë propozoj siq e cekti Halili dhe Nebihi që rasti i shtëpis të trajtohet, në bazë të fotografive 2000E janë të pa mjaftueshme vetëm kulmin me ja mbulu. Këto kërkesat e tjera as në mbledhjet tjera nuk i kisha sjellë.

Argjend Thaçi: Valon nuk e di përse po të vjen qudi sepse nuk është rasti i parë që po dëshirojmë me i ndihmu për shtallë kemi pasur dhe raste të tjera të cilat ju kemi ndihmu. Shtalla nuk është lluks dhe gjithmonë për zjarrë është shkaktar diqka dhe sigurisht që askush as me mjete piroteknike dhe as me rrymë nuk e djegë me qëllim.

Të gjitha kërkesat i kemi sjellë këtu, këtu është paradoksi që thua njëren kërkesë e sjell tjetrën jo, prandaj ne gjithmonë bëjmë përpjekje të i sjellim kërkesat si duhet dhe sipas nevojës. Në këtë

seancë kemi vendosur me i sjellë vetëm një kategori të zjarreve, ne nuk e kemi ndaluar asnjë kërkesë por nuk ju është ardhë radha me i sjellë këtu. Ne mundemi me i dallu vetëm me shumë sepse dhe atij që ju është djegur shtalla është mbajtur i familjes me atë shtallë, burim financiar e ka atë. Që nuk ka mjete financiare është tjetër gjë por të paktën me u solidarizim me ata. A ka dikush tjetër për diskutim?

Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Na shpjegoj dhe Drejtori rreth bugjetit dhe seriozisht na ndonjëher po i tejkalojmë ato mundësitë që i kemi. Gjithmonë kemi pasur kërkesa të cilat kanë qenë shumë të ndjeshme të rasteve të sëmundjeve të rënda, edhe ato kur i kemi aprovu i kemi aprovu shumë me zorrë për arsye të mungesës së bugjetit. Tani kanë fillu këto kërkesa me marrë një kahje tjetër për zjarr, për dëmtim të pronës, unë i kisha përkrah këta kolegë të cilët i dhanë propozimet. Te rasti i shtëpisë me mbështet ndërsa kërkesat e tjera të presin dhe të shohim kur i shoh dhe mundësitë Drejtori i Financave. Te shtëpia është mirë me marrë vendim me ja nda një shumë për arsye se tani po hyjmë në sezonën e vjeshtës dhe duhet me rregullu shtëpinë dhe me fut familjen në shtëpi. Këto dy kërkesa nuk po tham mos me i përkrahë, por në këtë seancë mos ti përkrahim të i shtyjmë për ndonjë seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Jemi te kërkesa nr. 01/287 e parashtruar nga Shkelzen Kryeziu, te propozimet. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Unë kisha propozuar të ja ndajmë 2000E një ndihmë minimale, solidarizuese me i tregu që ne kaq kemi mundësi për fatkeqësinë tënde këtë pjesë të shpenzimeve me ta mbulu. Nëse pajtohen dhe grupet e tjera 2000E për subvencionim të djegies së shtëpisë.

Argjend Thaçi: Kush është që kërkesës nr. 01/287 e parashtruar nga Shkelzen Kryeziu të ju ndahen mjetet financiare me shumën prej 2000.00E?

Me vota unanime 23 për, miratohet kjo kërkesë.

Pika tjetër është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/57, e parashtruar nga Liridon Gashi.

Raportin e keni, siq e cekëm është për djegie të shtallës dhe ushqimit për bagëti. A ka dikush për diskutim?

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ashtu siç e diskutuam në këtë kërkesë me shty për seancën e radhës, kjo nuk do të thotë që në seancën e radhës do të ja dhëjmë votën pro pa e parë të qartë vlersimin e Drejtorisë së Bujqësisë. Dhe vërejtje dhe KPF-së kur dëshorojnë me marrë një vendim ne duhet ta dimë sa para i ka Komuna jonë për këtë llojë të subvencionimit, qfarë kategorish i ki këto kërkesa, qfarë raste i ke të rënda të sëmundjeve dhe gjendjeve të rënda ekonomike të cilat i kanë njerëzit të cilëve ne nuk mundemi me ju ndihmu?

Për këtë arsye kërkoj që kjo pikë dhe pika e radhës të shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Dhe ne themi që ju në KPF vetëm thoni hajde ta dërgojmë në Kuvend pa ndonjë analizë të thellë, sepse kuvendi ja u ndan paratë. A më tregon sa përqind të rasteve të sëmundjeve të rënda të cilëve ju kemi ndihmu, ju kanë dalë mjetet?

Argjend Thaçi: Ju kanë dalë, jo të gjithave por në mënyrë sistematike janë duke ju paguar.

Nebih Bibaj: Unë po mendoj te qështja e zjarreve, pa ardhur ndonjë raport i detajuar nga Drejtoria e Bujqësisë nuk duhet me ardhë kërkesa këtu.

Argjend Thaçi: Kompetente për këtë Nebih, është Drejtoria e emergjencave dhe raporti i policisë, të cilët e bëjnë vlersimin.

Nebih Bibaj: Ky mandat ka pasur kërkesa të shumta dhe mendoj që kemi nda mjete edhe për disa persona që i kanë kushtet, secilës duhet me ja marrë raportin social. Ka njerëz të Komunës të cilët kanë nevojë për ndihmë por nuk din të bëjnë kërkesë dhe gjendjen ekonomike e ka katastrofë, sepse nuk ka kush me i tregu me bërë kërkesë në Kuvend. Ju them dhe anëtarëve të KPF-së kush do që nuk e arsyeton veten në KPF jepni votën kundër, sepse po luajn me ndjenja të njerëzve. Duhet me i trajtu kërkesat njëjtë dhe me shiku se nga është, qfar problem ka me analizu mos me na qit në lajthitje neve.

Argjend Thaçi: Ashtu po mundohemi me qenë Nebih, por kur po i vjen individualisht kërkesa po thoni pse nuk po i sjellë. Kërkesat individuale me u anku pse nuk po i sjell ndërsa kërkesat e përgjithshme pse po i sjellë të gjitha. Duhet me qenë më liberal.
Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Pozita e Kryesutit është me udhëheq mbledhjen, dhe nuk është me debat për qështje të KPF-së Kryesusi, por nëse ke diqka e merr fjalën dhe del në foltore. Asnjë kërkesë personale e jona nuk është ardhë për me sjell në Kuvend, ka zyrtar të Komunës që kanë qenë të sëmurë ju ka kushtuar intervenimi ka 12-13,000.00E dhe ka bërë kërkesë këtu në Komunë për me mbështet si punëtor 22 apo më shumë vite, nuk keni qenë në gjendje me ja nda 500.00E. Ja keni refuzu në KPF, nuk e keni sjell në Kuvend, ju e keni parë të arsyeshme që e keni refuzu. Kërkesat duhet me i reduktu dhe subvencionet planifikohen, i ki subvencionet në bujqësi por i ki të destinuara në bugjet për qfarë ki me i shpenzu. Niveli lokal në tërë Kosovën nuk ka kod bugjetor i cili thotë po i ndajmë disa mjete dhe po i shpenzojmë qysh dëshirojmë. Edhe këti që ju është djegur shtalla që mundemi ju ndihmojmë, por kur e kryqëzojna rastin me sëmundje dhe po i trajtojmë këto, ai me shtëpi është normale ai punon por me rregullu shtëpin duhet një shumë e madhe e parash për me ja fillu dhe ai nuk mundet menihërë me i siguru, ne Komuna po ja ndajmë 2000.00E për me i ndihmu sa do pak me u solidarizu.

Argjend Thaçi: Atëheer kush është për që kërkesa nr. 01/57, e parashtruar nga Liridon Gashi të shtyhet për ndonjë seancë tjetër?

Me vota unanime, kjo kërkesë shtyhet.

Kush është për që kërkesa nr. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/403, e parashtruar nga

Sami Thaçi të shtyhet për ndonjë seancë tjetër?

Me vota unanime konsideroj që dhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është kërkesa nr.01/385 e hyrë si pikë e re në këtë mbledhje pasi që ka qenë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e fundit. Kërkesa e parashtruar nga Adem Hoti i cili ka kërkuar pronë për ndërtimin e shtëpis, i cilit do ti ndërtohet nga donatorët.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne këtë kërkesë e kemi trajtuar në mbledhjen e kaluar dhe e kemi parë që është në një situatë të gjendjes së rëndë ekonomike. Unë kërkoj që ne ta përfundojmë detyrën tonë, unë nuk e di se si shkon kjo punë juridikisht, por ne si grup e shprehim vullnetin tonë dhe votojmë pro ndarjes së kësaj parcele, për ndërtimin e shtëpis nga organizata humanitare meqë ai person nuk ka asnjë pronë të vetën.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Për rastin në fjalë dhe për rastin i cili është mbas kësaj kërkesë, prej informacioneve të cilat i kam marrë prej kolegëve asambleistë dhe prej qytetarëve të dyja janë raste të rënda. Mirëpo kjo nuk kalon në MAPL një qështje e tillë, kështu që nuk jam për me aprovu sepse dalim keq. Rastet janë të njëta si për këto shtëpitë që po i ndërtojnë për Komunitet dhe ata kanë bërë fillimisht kërkesa me ja liru pronën publike mirëpo nuk mundesh me i legalizu ato. Ata po i ndërtojnë shtëpitë dhe pa leje të Komunës, dhe këta dy persona leti ndërtojnë në pronën publike dhe nëse nuk i vënë ajo pronë Komunës asnjëherë mos të ja merr, por ne nuk mundemi me i dhënë ligjshmëri kësaj, sepse ta kthen MAPL-ja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebi Bibaj!

Nebih Bibaj: Kryesus, ne këtu po bëmë në konflikt dhe me kolegë, ne kemi me votu këtu pro, ne këtu nuk duhet të bëjmë politik nuk duam të mashtrojmë njerëz. Më e ligjshme ka qenë ai me i marrë nënshkrimet e kryesis së fshatit që ajo pronë nuk i pengon bashkë qytetarët e vetë, që dikush me u qu kundër tij përse po e ndërton këtë shtëpi. Po flasim në kuadër të kornizave ligjore, ligji thotë: Prona publike nuk mund të jipet as të falet, i jipet dikujt në shfrytëzim me një qëllim të arsyeshëm. Ne jemi pro shpresojmë të ja lejon MAPL-ja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima: Nëse ne ja ndajmë pronën dhe ja ndërtojnë shtëpinë organizata humanitare, si doni me ja zgjedh problemin e ujit, kanalizimit. Unë e di një rast, një mërgimtar ja ka ble pronën X përsonit, shtëpinë ja ka ndërtu shoqata, ndërsa për bunar nuk i ka plotësuar kriteret për me jas hap bunarin. Ndërsa i ka plotësuar kriterin për me hap bunarin personi i cili i ka dy paga të deklaruara në shtëpi ndërsa ky jo. Ne ja lejojmë, por kush ja siguron ujin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Hamit, ai nuk ka kërkuar me ja zgjedh problemin e ujit ka kërkuar me ja zgjedh problemin e shtëpis. Ne nuk jemi duke falë pronë, unë po e ceki me marrë një vendim me të cilin ne i thojmë shoqatës humanitare që e ki lejen tonë për me ja ndërtu shtëpin aty zotëris aty nuk na pengon asgjë duke e pasur parasysh gjendjen e tij ekonomike. Ne nuk mundemi me preokupu mendimin e MAPL-së, ndoshta MAPL-ja e drejton këtë qështje në bazë qysh po e vlersojmë ne. Por nëse e kthen ne jemi munduar me bërë tonën, ne nuk jemi duke e mashtruar askënd sepse dhe anëtarët e KPF-së dhe ekzekutivi ja ka treguar që mundet me pas problematik dhe mundet me tu kthy. Qytetarët e fshatit ja kanë dhënë nënshkrimin që po mundesh me ndërtu.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Unë pajtohem me Halilin dhe Nebihin me një pjesë të tij që neve po na sërvohe disa pika që neve po na qesin para një akti shumë të sikletshëm, sepse aty zotëris ju është ofruar mundësia me ju ndërtu një shtëpi por nuk ka pronë në emër të vetin, dhe ka kërkuar një zgjidhje nga ne.

Sa i përket asaj që po flet Hamiti nëse ka ndonjë rast që ju ka mohu e drejta për me hap një bunar prej Katarit që nuk po mundet me hi në shtëpi për arsye të ujit, leti merr të gjithë shefat e grupeve të shkon te ajo shtëpi leta konstatojn që vërtet është ashtu ne mundemi me ja hap një bunar.

E gjithë prona publike është shitur Hamit nga LDK- dhe PDK në atë kohë, ne nuk mundemi me marrë rastin e sodit duke u kthy në atë që ka ndodhë në të kaluaren. Për me ja bërë një zgjidhje njeriut me ja ndërtu një shtëpi, një personit i cili ka nevojë për ne, nëse na lejohet me ligj thotë: Për me ja leju në shfrytëzim mundesh, por duhet me pagu qera dhe duhet me cekë qfarë ka me bërë ai në atë pronë publike, si ka me shfrytëzu atë pronë. Nëse kish bërë unë po propozojë që me nxerr një vendim siq e ceki dhe Halili, jo me ja dhënë ne shfrytëzim por vetëm me i dhënë pëlqim, ne po ja dhëjmë pëlqimin që ai me ndërtu shtëpin aty deri në një kohë kur Komunës i duhet ajo pronë. Prona publike nuk shitet, nëse mundemi nëse i kryenë punë ne mundemi me ja dhënë një pëlqim me një afat të caktuar apo deri sa toka i duhet Komunës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Driton Kastrati!

Driton Kastrati: Unë pajtohem me Valonin që ta marrim një vendim si lloj pëlqimi deri në një kohë kur i duhet Komunës ajo pronë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Unë pajtohem me deklaratën e Nebihit kur e ceki që duhet të mirret pëlqimi i Komunitetit. Ne kemi raste kur prona publike në shumë fshatra janë ndërtuar shumë shtëpia për ahengje të ndryshme aty, nuk e dimë qfarë pëlqimi kanë marrë. Edhe rasti i këti nëse është rast i ndishëm, ne e përfundojmë punën tonë driten e gjelbërt ja dhëjmë prej kuvendit e ka pëlqimin dhe nënshkrimet e fshatit besoj që do ti bëjmë zgjidhje dhe ta përfundoj punën e vetë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih Bibaj!

Nebih Bibaj: Nuk më pëlqej ajo që Valoni ngriti proteza për qështje politike mbi privatizim, kush e ka privatizu duhet me ja fillu prej shtyllës katër besoj e din ai dhe duhet me dalë te partit politike liderve të partive politike. Nuk është mirë me punu me emra PDK dhe LDK, por me gjithë atë ne e ndajmë pronën qfarë bënë ministria tani e tuje nuk e dim ne. Unë ja kisha zgjedh dhe një rrugë më të lehtë nuk ka pasur nevojë me ardhë në Kuvend, por pasi nuk keni pytë në rregull është.

Argjend Thaçi: Atëherë e hudhim në votim kush është për dhënie të pëlqimit prej 4.5 ari, për ndërtimin e shtëpis në parcelën sipas kërkesës nr.01/385, sipas kërkesës së shoqatës humanitare që ti ndërtohet shtëpia nga donatori. Kush është për?

20 anëtarë jemi të pranishëm.

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 19 vota për, 0-Kundër, dhe 1-abstenim miratohet kjo kërkesë.

Pikën e radhës e kemi të natyrës së njëjt kush është për dhënien e pëlqimit prej 4.5 ari për ndërtimin e shtëpis sipas kërkesës së donatorëve për ndërtimin e shtëpis, për parcelën të parqitur sipas kërkesës nr. 02/687. Kush është për?

Me vota unanime konsideroj që miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani: Dëshirova ta ceki para jush datën e 30 Gushtit si një ditë e rëndësishme, dita ndërkombëtare e personave të pagjetur. Kosova ka mbi 1600 persona të zhdukur tash e dy dekada, ku prej tyre janë 39 nga Komuna e Malishevës. Nga kjo foltore ne i bëjmë thirrje që të ndriqohet sa më parë fati i qytetarëve të zhdukur, ndërsa ne nuk duhet të ndalemi asnjëherë duke kërkuar drejtësi për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Nder dhe respekt për të gjitha familjet e të zhdukurve të cilat dhe pas dy dekadave jetojnë me plagë në zemrat e tyre.


Desha të kërkoj dhe diqka nga zyra e Kryesusit, unë vetëm po e propozojë sepse e kam marrë një përvoj nga një vizitë në një Komunë tjetër dhe më ka pëlqyer lista e Komisioneve që bëhet. E kam parë që është një listë standarte e nënshkrimit të anëtarëve të Komisioneve, kërkoj që listës aktuale të i shtohen dhe dy apo tri kolona për me u nënshkru mysafirët. Në Komitetin për Komunitete në qdo mbledhje kemi musafir dhe në qdo mbledhje jemi në teren, është mirë të nënshkruhen dhe musafirët të cilët janë prezent.

Argjend Thaçi: Kërkoj që deri të premten të i sjellni konfirmimet e bankës të gjithë anëtarët e Komisioneve, sepse na duhen me i bërë disa lista të reja.

E shpalli të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoi në ora: 16:30.

Procesmbajtësja:
Argenitë Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit
Agjond Thaçi:

